

PËR MËSUESIN/EN

duk gjini
shtëpia botuese publishing house

**Njomza Lila-Babuni,
Majlinda Haxhikadrija-Ramadani,
Katarina Gojani, Valdete Gjakova**

NJERIU DHE NATYRA

Për klasën e parë të arsimit fillor



PËRMBAJTJA

Parathënie.....	4
Udhërrëfyes	5
Hyrje.....	7
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1.....	10
Rezultatet e të nxënit të fushës së shkencave natyrore: Shkalla 1	13
Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi (klasa e parë)	14
Plani dymujor: shtator—tetor.....	15
Plani dymujor: nëntor—dhjetor	18
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	21
Plani tremujor: prill—maj—qershor	24

1. Materia, vetitë dhe shndërrimet

Mësimi 1: Identifikimi i materialeve dhe përbërja e tyre.....	28
Mësimi 2: Origjina e materialeve	30
Mësimi 3: Vetitë e materialeve	32
Mësimi 4: Përdorimi i materialeve	34
Mësimi 5: Ndikimi i ujit në materiale të ndryshme.....	36
Mësimi 6: Ndryshimi i ngrohjes dhe i ftohjes në materiale të ndryshme	38
Mësimi 7: Trupi im	40
Mësimi 8: Dallimi gjinor	42

2. Bota e gjallë

Mësimi 9: Higjiena.....	44
Mësimi 10: Ngjashmëritë dhe dallimet mes qenieve të gjalla	46
Mësimi 11: Bimët	48
Mësimi 12: Kafshët.....	50
Mësimi 13: Njerëzit	52
Mësimi 14: Mjediset jetësore të qenieve të gjalla.....	54
Mësimi 15: Vetitë fizike të trupave	56
Mësimi 16: Pozita e trupave.....	58

3. Proceset fizike

Mësimi 17: Qetësia dhe lëvizja e trupave	60
Mësimi 18: Zëri	62
Mësimi 19: Drita	64
Mësimi 20: Vendndodhja dhe orientimi në natyrë.....	66
Mësimi 21: Moti.....	68

4. Toka, mjedisi dhe Gjithësia

Mësimi 22: Moti (përsëritje).....	70
Mësimi 23: Mjedisi rrethues.....	72
Mësimi 24: Mjedisi rrethues (përsëritje)	74
Mësimi 25: Harta dhe globi.....	76
Mësimi 26: Burimet natyrore - Ajri	78
Mësimi 27: Ndotja e ajrit	80

Mësimi 28: Uji.....	82
Mësimi 29: Uji (përsëritje).....	84
Mësimi 30: Ndotja e ujit	86
Mësimi 31: Toka.....	88
Mësimi 32: Ndotja e tokës	90
Mësimi 33: Ta ruajmë mjedisin	92
Mësimi 34: Ta ruajmë mjedisin (përsëritje).....	94

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimit. Sot kemi mundësinë që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimit ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimit dhe të nxënimit, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e nxënimit dhe mësimit përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lipset të përdorni metoda dinamike të mësimit, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES

për konceptimin e mësimëve model

Faqja në të majtë


- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Rezultatet e të nxënës të temës janë në koherencë me ato të fushës.
- Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënës, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zërthim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënës të klasës.



- Paraqitja e faqes së librit të nxënës ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Të gjitha mjetet dhe materialet që ndihmojnë në konkretizim.
- Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentohen.
- Metodologjia e mësimin ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathësi të reja.

Faqja në të djathtë

- Paraqitja e faqes së librit të nxënës ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Figurat, tabelat, diagramet etj., janë ndihmë për të gjithë mësuesin në aspektin pamor, për sukses në zhvillimin e mësimin.
- Për t'i përforcuar ditjet dhe shkathësitë, në fund të mësimin jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



- Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mësimin ku, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënës bëhet më tërheqës dhe nxënës bëhen aktivë, duke u përfshirë në veprimtari të ndryshme.
- Veprimtari të në këtë hap a këta hapa të mësimin udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënës i kryejnë ato sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.
- Hapi i fundit është praktikë e pavarur ku nxënës inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtari të, por tashmë të pavarur dhe inkurajohen duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimin

Rezultatet e të nxënës të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënës për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me kurrikulën bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënës të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënës dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e kurrikulës bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënësve: Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimin, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës, të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zërthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - hapat e zhvillimit të mësimin: Meqenëse nxënësit e klasës së parë dhe të dytë mësojnë konceptet dhe shkathtësitë fillestare, në këtë fazë të zhvillimit ata përparojnë në drejtim të zotërimit të tyre, por nuk i zotërojnë operacionet mendore, prandaj edhe të menduarit e tyre është paraoperacional, kështu që mësimi kalon përmes hapave.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit?



Mbillet një farë në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera.

Këto tri figura jepen së bashku, njëra pas tjetrës, çka sugjeron që mësuesi duhet të ndërtojë mësimin mbi të mëparshmen dhe të ketë parasysh se çfarë mund të vijojë. Sikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.

Në këto klasa mësimi zhvillohet në hapa, të cilët, sipas lëndës dhe veçorisë, mund të jenë tre ose edhe më shumë, por gjithsesi mësimi do të ndjekë këtë ecuri.

Hyrje: Identifikohen njohuritë dhe shprehjet fillestare të nxënësve që të nxiten interesi i tyre për mësimin. Pjesa kryesore e mësimin: Mësuesi/ja, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, synon ta bëjë tërheqës të nxënësve të mësimin përmes veprimtarive të ndryshme, duke përdorur mjete të larmishme konkretizuese, figura, tabela, fotografi, video dhe të tjera.

Praktikë e udhëhequr: Veprimtaritë në këtë etapë të mësimin kërkojnë që të udhëhiqen nga mësuesi dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve a duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Praktikë e pavarur: Nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe nxiten duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin

NJERIU DHE NATYRA 1

Fokusi kryesor i të mësuarit në fushën *Shkenca e natyrës* përmban bazën e të kuptuarit të botës përmes koncepteve në lëndën mësimore *Njeriu dhe natyra*. Nxënësit, që në moshë të hershme, njihen me dukuritë shkencore si tërësi dhe ndikimin e tyre në funksionimin e shoqërisë dhe natyrës.

Në klasën e parë nxënësit mësojnë për aspektet thelbësore të njohurive, metodave, proceseve dhe përdorimit të shkencës. Ata inkurajohen të kuptojnë se si shkenca mund të përdoret për të shpjeguar se çka ndodh rreth tyre dhe t'i analizojnë shkaktarët.

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për *shkenca natyrore*, brenda orës mësimore dhe jashtë saj, në realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare nevojitet përdorim i përshtatshëm i metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat dhe për fushën *Shkenca e natyrës*, e përkatësisht rezultatet lëndore, paraqesin jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve, por edhe për përzgjedhjen e metodologjive, duke u harmonizuar njëra me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve, në kontekst të filozofisë dhe parimeve të Kornizës Kurrikulare.

Suksesi i nxënësve në lëndën *Njeriu dhe natyra* varet nga puna dhe angazhimi i mësuesit/es dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje krijuese, ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore, si dhe metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike në laborator, klasë si dhe të nxënësve në natyrë.

Mësimdhënia për nxënësit e klasës së parë realizohet përmes ilustrimeve, provave dhe lojërave, nën mbikëqyrjen e mësuesit, duke pasur parasysh kohën në dispozicion për nevojat dhe kërkesat e tyre, natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, bazën didaktike dhe stilet e të nxënësve.


Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënësve

Ky libër është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai i trajton temat mësimore në përputhje me "Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës" (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të fushës, rezultatet specifike të të nxënësve të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe mospërfundimin,

dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënësve - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënësve - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “trekëndësh magjik”. Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënësve, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënësve dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.



Burimi: Metodologji e mësimdhënies, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Musai, B. (2014)

Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënësve e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e




Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk, A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmohatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënësia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimin midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmohatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: "Psikologji edukimi", (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Sipas Piazhësë, fëmijët e klasës së parë dhe të dytë bëjnë pjesë në stadin paraoperacional dhe proceset kryesore të të menduarit tek ata bazohen kryesisht në vëzhgim. Në këtë mënyrë, është e mundur të kultivohen elementet dhe shprehitë e para të të menduarit kritik; por edukimi në mënyrë sistematike i tyre, që bëhet më pas shprehi e rëndësishme e të menduarit të nivelit të lartë, fillon në klasën e tretë. Për këtë arsye, mësimet janë të strukturuar në disa hapa të thjeshtë, të cilët me kujdes dhe në mënyrë të përshkallëzuar, japin ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe krijimin e dijeve, si dhe formimin e shprehive.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
2.	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
4.	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
5.	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimi, vizatimi, dramatizimi (luajtja në role), këndimi apo vallëzimi.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
7.	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore, si dhe e prezanton para të tjerëve.
8.	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo interpretimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.
9.	Emërton në gjuhën e huaj objekte, veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e tij.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
5.	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.
6.	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III. Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm	
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëroret etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkohet zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkohet këshilla/informacione kur has në vështirësi.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
1.	Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre.
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/ shkollë apo jashtë saj).
3.	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
4.	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërit nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
6.	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anashjell në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
1.	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
3.	Bën një listë (me njërën nga format shprehëse, si: shkrim, vizatim etj.) me ushqimet të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa parandaluese për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.
4.	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
6.	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
1.	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë.
2.	Diskuton në grup dhe, së bashku me anëtarët e tjerë të grupit, i vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si: rregullat për realizimin e aktiviteteve, të mirësjelljes, të higjienës etj.
3.	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
4.	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
5.	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe përshkruan, përmes formave të ndryshme të shprehjes, kontributin individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
7.	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilat kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

Rezultatet e të nxënimit të fushës së Shkencave natyrore: Shkalla 1

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT, SHKATHËSITË përmes të cilave nxënësi/ja:	
Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike, gjeografike në Tokë dhe Gjithësi).	
Nxënësi/ja:	
1.	Vrojton, përshkruan dhe krahason materialet, sipas origjinës, përbërjes, vetive, madhësisë, formës, shndërtimeve dhe përdorimit në jetën e përditshme.
2.	Vrojton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojllojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror, si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror.
3.	Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojllojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale.
4.	Dallon gjendjen e qetësisë nga gjendja e lëvizjes së trupave, përshkruan lloje të ndryshme të lëvizjeve duke i vendosur në lidhmëri me veprimin e forcave.
5.	Identifikon burimet e ndryshme të energjisë (duke përfshirë rolin e nxehtësisë së diellit për jetën në Tokë) për shfrytëzimin efikas të tyre për jetën e njeriut.
6.	Identifikon mënyrat e orientimit dhe lëvizjet në hapësirë, dhe tregon forma të thjeshta të bashkëveprimit në relacionin njeri-natyrë, dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm në rrethin ku jeton e më gjerë, tregon për rolin që ka në ruajtjen e mjedisit dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër.
7.	Përshkruan veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore).
II. Zhvillimi i shkathësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë	
Nxënësi/ja:	
1.	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij.
2.	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara, për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij.
3.	Kryen prova të thjeshta ku problemi, materialet dhe metoda përzgjidhen nga mësuesi/ja.
4.	Grupon dhe klasifikon objektet sipas karakteristikave të vëzhgueshme (ngjyra, forma, madhësia, të ushqyerit).
5.	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim.
6.	Grumbullon dhe mban shënime që i ndihmojnë për të arritur deri te përgjigjet.
7.	Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdorur fotografi, vizatime, modele dhe metoda të tjera.
III. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen	
Nxënësi/ja:	
<ul style="list-style-type: none"> • Kureshtja për hulumtimin e botës së gjallë dhe jo të gjallë në natyrë. • Qëndrimi ndaj pyetjeve dhe përpjekje për të gjetur përgjigje. • Interesimi për të njohur karakteristikat dhe nevojat jetësore të qenieve të gjalla. • Kujdesi për jetën personale, shëndetin e tij dhe të tjerëve. • Kujdesi gjatë përdorimit të veglave dhe mjeteve, si dhe respektimi i rregullave të sigurisë gjatë punës. 	
IV. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË që zhvillohen	
Identifikim; përshkrim; zbatim; njehsim; matje; skicime; demonstrim; hulumtim, modelim; krahasim; vlerësim.	

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Njeriu dhe Natyra
Klasa 1

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës 1 (Klasa I).	
	PERIUDHA I		PERIUDHA II	PERIUDHA III		
	Shtator—tetor	Nëntor—dhjetor	Janar—shkurt—mars	Prill—maj—qershor		
SHOQËRIA DHE MJEDISI 1	Përbërja, vetitë dhe përdorimi i materialeve	Vetja	Emërtimet për pozitën e trupave, sasinë dhe llojet e materialeve	Bashkëveprimi njeri-naturë	I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv 1, 3, 4, 7 II Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ 1, 3, 4, 6, 8 III Kompetenca e të nxënimit – Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 IV Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv 2, 4, 5, 6 V Kompetenca personale – Individ i shëndoshë 1, 2, 5, 7 VI Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm 2, 6	
	Materialet dhe shndërrimet	Gjallesat dhe rritja e tyre	Qetësia, lëvizjet, zëri dhe drita			
	Vetja		Vendi dhe hapsira			
			Sistemet fizike			
	8 orë	8 orë	12 orë	9 orë		

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: I

Tema mësimore:

- Përbërja, vetitë dhe përdorimi i materialeve
- Materialet dhe shndërrimet
- Vetja

RNK - rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;
I.4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur;
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve;

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikor, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre;

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;
III.5	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjime të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkohet zgjidhjen e problemit të dhënë;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;
III.7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkohet këshilla/informacione kur has në vështirësi;

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.4	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup;
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj;
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.);

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Diskuton në grup dhe, së bashku me anëtarët e tjerë të grupit, i vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si: rregullat për realizimin e aktiviteteve, të mirësjelljes, të higjienës etj.;
VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;

RNF - rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Vrojton, përshkruan dhe krahason materialet, sipas origjinës, përbërjes, vetive, madhësisë, formës, shndërtimeve dhe përdorimit në jetën e përditshme.
-----	--

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Përbërja, vetitë dhe përdorimi i materialeve	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon materialet që përdoren në mjedis (ndërtimtari, rroba, vegla, lodra, ushqime); - Emërton materiale me origjinë natyrore dhe të krijuara nga njeriu; - Grupon objektet sipas materialeve që i përbëjnë ato (tekstil, gomë, metal, plastikë, qelq, dru, argjilë); - Përkrauan vetitë fizike të materialeve të jetës së përditshme (fleksibiliteti, transparencë, fortësia, vetia magnetike); - Përkrauan përdorimin e materialeve të ndryshme; Hulumon ndikimin e ujit në lloje të ndryshme të materialeve; - Përkrauan ndikimin e ngrohjes dhe ftohjes në lëndë të ndryshme (çokolatë, ujë, akullore, vezë); - Tregon funksionin e pjesëve të trupit të tij\ saj; - Tregon dallimin gjinor të njeriut përmes karakteristiake fizike (femër dhe mashkull). 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i materialeve dhe përbërja e tyre. 2. Origjina e materialeve. 3. Vetitë e materialeve. 4. Përdorimi i materialeve. 5. Ndikimi i ujit në materiale të ndryshme. 6. Ndryshimi i ngrohjes dhe i ftohjes në materiale të ndryshme. 7. Trupi im. 8. Dallimi gjinor (vajzë dhe djalë) 	8	<p>DRTA</p> <p>Stuhi mendimesh</p> <p>Turi i galerisë</p> <p>Gushëkuqi rrethor</p> <p>Copëza të përziera</p> <p>Teknika e pyetjeve</p> <p>Rrjeti i diskutimit</p> <p>Parashikim me terma paraprakë</p> <p>Imagjinatë e drejtuar</p> <p>Kubimi</p> <p>Shkrim i lirë</p> <p>Pesëvargësh</p> <p>Lexim në dyshe</p> <p>Mësimdhënia reciproke</p> <p>Të nxënë të bashkëpunim</p> <p>Mbledhja e të dhënave</p> <p>Projekte</p> <p>Eksperimente</p>	<p>Pjesëmarrja në aktivete</p> <p>Listë kontrolli</p> <p>Semafori</p> <p>Informata kthyesë</p> <p>Vlerësimi i ndërsjellë</p> <p>Dy yje, një dëshirë</p> <p>Vëzhgimi</p> <p>Kontrolli para fluturimit</p> <p>Vlerësimi i projekteve</p> <p>Vlerësimi i portofolit</p> <p>Vlerësimi i punës praktike eksperimentale</p>	<p>Gjuhë amtare</p> <p>Ed. fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Jeta dhe puna</p> <p>Arte</p> <p>Çështje ndërkulturale</p> <p>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukimi për paqe</p>	<p>Njeriu dhe natyra I</p> <p>Njeriu dhe natyra I - fletore pune (Sh. B. Dukagjini)</p> <p>Paketa e gjelbër</p> <p>Burime nga interneti (filma, dokumentarë, videoeksperimente)</p> <p>Burime njetëzore</p> <p>Enciklopedi</p> <p>Atlase</p>
Materialet dhe shndërrimet							
Vetja							

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: I

Tema mësimore: - Vetja
- Gjallesat dhe rritja e tyre

RNK - rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;
I.4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur;
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve;

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Gjen veçoritë (në njërën nga aspektet: matematikor, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre;
II.6	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse;

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit;
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;
III.5	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;
III.7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla/informacione kur has në vështirësi;

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialiet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.1	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron;
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj;
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.);

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.;
VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;

RNF - rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.2	Vrojton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojllojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror, si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror;
1.3	Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojllojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.2	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara, për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.3	Kryen prova të thjeshta ku problemi, materialet dhe metoda përzgjidhen nga mësuesi/ja;
2.4	Grupon dhe klasifikon objektet sipas karakteristikave të vëzhgueshme (ngjyra, forma, madhësia, të ushqyerit);
2.5	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim;
2.6	Grumbullon dhe mban shënime që i ndihmojnë për të arritur deri te përgjigjet;
2.7	Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdorur fotografi, vizatime, modele dhe metoda të tjera.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Metodologjia e mësimdhënies	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Vetja	<ul style="list-style-type: none"> - Tregon funksionin e pjesëve të trupit të tij/saj; - Përshkruan rëndësinë e higjienës së pjesëve të trupit; - Tregon dallimin gjinor të njeriut përmes karakteristikave fizike (femër dhe mashkull); 	<ol style="list-style-type: none"> 9. Higjiena personale 10. Ngjashmëritë dhe dallimet mes qenieve të gjalla 11. Bimët 12. Kafshët 13. Njerëzit 14. Mjediset jetësore të qenieve të gjalla 15. Vetitë fizike të trupave 16. Test vlerësues 	8	<p>Pjesëmarrja në aktivitete</p> <p>Listë kontrolli</p> <p>Semafori</p> <p>Informata</p> <p>thyesë</p> <p>Vlerësimi i ndërsjellë</p> <p>Dy yje, një dëshirë</p> <p>Vëzhgimi</p> <p>Kontrolli para fluturimit</p> <p>Vlerësimi i projekteve</p> <p>Vlerësimi i portfolios</p> <p>Vlerësimi i punës</p> <p>praktike eksperimentale</p>	<p>DRTA</p> <p>Stuhi mendimesh</p> <p>Turi i galerisë</p> <p>Gushëkuqit rrethor</p> <p>Copëza të përziera</p> <p>Teknika e pyetjeve</p> <p>Rrjeti i diskutimit</p> <p>Parashikim me terma paraprakë</p> <p>Imagjinatë e drejtuar</p> <p>Kubimi</p> <p>Shkrim i lirë</p> <p>Pesëvargësh</p> <p>Lexim në çifte</p> <p>Mësimdhënia reciproke</p> <p>Të nxënësit në bashkëpunim</p> <p>Mbledhja e të dhënave</p> <p>Projekte</p> <p>Eksperimente</p>	<p>Gjuhë amtare</p> <p>Ed. fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Jeta dhe puna</p> <p>Arte</p> <p>Çështje ndërkurrikulare</p> <p>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukimi për paqe</p>	<p>Njeriu dhe natyra I</p> <p>Njeriu dhe natyra I - fletore pune (Sh. B. Dukagjini)</p> <p>Paketa e gjelbër</p> <p>Burime nga interneti (filma, dokumentarë, videoeksperimente, materiale tekstuale, fotografi, programe instruktive, video etj.), enckilopedi, atlase etj.</p>
Gjallesat dhe rritja e tyre	<ul style="list-style-type: none"> - Tregon funksionin e pjesëve të dallime mes bimëve dhe kafshëve; - Tregon nevojat e ndryshme për jetë të njeriut dhe kafshëve; - Demonstron nevojat e rritjes së bimëve për dritë dhe ujë; - Identifikon mjediset jetësore të qenieve të gjalla; - Identifikon ndërlidhjen mes qenieve të gjalla dhe mjedisit; 						

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: I

Tema mësimore:

- Emërtimet për pozitën e trupave, sasinë dhe llojet e materialeve
- Qetësia, lëvizjet, zëri dhe drita;
- Vendi dhe hapësira;
- Sistemet fizike

RNK - rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;
I.4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur;
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve;

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikor, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;
II.3	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e tij;
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre;
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin/detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;
III.5	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjime të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;
III.7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkon këshilla/informacione kur has në vështirësi;

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet a materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë, shkollë apo jashtë saj);
IV.4	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup;
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj;
-----	---

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;
------	--

RNF - rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.4	Dallon gjendjen e qetësisë nga gjendja e lëvizjes së trupave, përshkruan lloje të ndryshme të lëvizjeve, duke i vendosur në lidhshmëri me veprimin e forcave;
1.5	Identifikon burimet e ndryshme të energjisë (duke përfshirë rolin e nxehtësisë së diellit për jetën në Tokë) për shfrytëzimin efikas të tyre për jetën e njeriut;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.2	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara, për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.3	Kryen prova të thjeshta ku problemi, materialet dhe metoda përzgjidhen nga mësuesi/ja;
2.4	Grupon dhe klasifikon objektet sipas karakteristikave të vëzhgueshme (ngjyra, forma, madhësia, të ushqyerit);
2.5	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim;
2.6	Grumbullon dhe mban shënime që i ndihmojnë për të arritur deri te përgjigjet;
2.6	Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdorur fotografi, vizatime, modele dhe metoda të tjera.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Emërtimet për pozitën e trupave, sasinë dhe llojet e materialëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon objektet dhe trupat në përditshmëri; - Cakton objekte dhe trupa që shprehin kuptimet: i madh, i vogël, shumë, pak, shpejt, ngadalë, nën, mbi, afër, larg, majtas, djathtas, poshtë, lart, nxehtë, ftohtë, i rëndë, i lehtë, i ndritshëm, më pak i ndritshëm, i lëmuar, i vrazhdë etj.; - Dallon trupin nga materiali prej të cilit është i ndërtuar; 	<ol style="list-style-type: none"> 17. Pozita e trupave 18. Qetësia dhe lëvizja e trupave 19. Zëri 20. Drita 21. Vendndodhja dhe orientimi në natyrë. 22. Moti 23. Moti (përsëritje) 24. Mjedisi rrethues 25. Mjedisi rrethues (përsëritje) 26. Harta dhe globi. 27. Ajri 28. Test vlerësues 	12	<p>DRTA</p> <p>Stuhi mendimesh</p> <p>Turi i galerisë</p> <p>Gushëkuqi rrethor</p> <p>Copëza të përziera</p> <p>Teknika e pyetjeve</p> <p>Rrjeti i diskutimit</p> <p>Parashikim me terma paraprakë</p> <p>Imagjinatë e drejtuar</p> <p>Kubimi</p> <p>Shkrim i lirë</p> <p>Pesëvargësh</p> <p>Lexim në dyshje</p> <p>Mësimdhënia reciproke</p> <p>Të nxënë në bashkëpunim</p> <p>Mbledhja e të dhënave</p> <p>Projekte</p> <p>Eksperimente</p>	<p>Pjesëmarrja në aktivitete</p> <p>Listë kontrolli</p> <p>Semafori</p> <p>Informata kthyese</p> <p>Vlerësimi i ndërsjellë</p> <p>Dy yje, një dëshirë</p> <p>Vëzhgimi</p> <p>Kontrolli para fluturimit</p> <p>Vlerësimi i projekteve</p> <p>Vlerësimi i portfolios</p> <p>Vlerësimi i punës</p> <p>praktike eksperimentale</p>	<p>Gjuhë amtare</p> <p>Ed. fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Jeta dhe puna</p> <p>Arte</p> <p>Çështje ndërkurrikulare</p> <p>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukimi për paqe</p>	<p>Njeriu dhe natyra I</p> <p>Njeriu dhe natyra I - fletore pune (Sh. B. Dukagjini)</p> <p>Paketa e gjelbër</p> <p>Burime nga interneti</p> <p>CD</p> <p>(filma dokumentarë, videoeksperimente)</p> <p>Burime njerëzore</p> <p>Enciklopedi</p> <p>Atlase</p>
<p>Qetësia, lëvizjet, zëri dhe drita</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Tregon shembuj të gjendjes së qetësisë dhe lëvizjes së trupave; - Dallon zëra të ndryshëm që prodhojnë instrumentet muzikore, përmes lojërave, vallëzimit, muzikës dhe këngëve; - Emërton burime të dritës që i njeh nga përditshmëria; - Tregon kuptimin për vendndodhjen/vendin, horizontin (horizontin e hapur dhe të mbyllur), vijën e horizontit dhe drejtimit kryesor të horizontit (V, L, J, P); 						
<p>Vendi dhe hapësira</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Liston disa mënyra elementare të orientimit në natyrë; - Përcakton drejtimit kryesor të horizontit (V, L, J, P), duke i bërë të njohur një nga pikat e horizontit p.sh. Peja gjendet në P, gjen pikat e tjera; - Tregon karakteristikat e motit (me shi, me diell, i nxehtë, i ftohtë, stuhi, borë, ngricë), përshatja me motin në jetën e përditshme. 						
<p>Sistemet fizike</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përkrauan mjedisin përreth tyre, duke përdorur termat <i>fushë, kodër, mal, lumë, përrua, liqen</i> etj. - Tregon në hartë ose në glob që pjesa më e madhe e tokës është ujë. 						

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: I

Tema mësimore: - Bashkëveprimi njeri-natyrë

RNK - rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;
I.4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur;
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve;

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikor, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre;
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet a mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;
III.5	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë;
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;
III.7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla/informacione kur has në vështirësi;

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.2	IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.4	IV.4 Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup;
IV.5	IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj;

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;

RNF - rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.6	Përshkruan veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore).
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.2	Përdor të gjitha shqisat, të ndara apo të kombinuara, për të shpjeguar qeniet e gjalla, objektet dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij;
2.3	Kryen prova të thjeshta ku problemi, materialet dhe metoda përzgjidhen nga mësuesi/ja;
2.5	Sugjeron përgjigje për pyetje të ndryshme, duke u bazuar në vëzhgim;
2.6	Grumbullon dhe mban shënime që i ndihmojnë për të arritur deri te përgjigjet;
2.7	Prezanton të dhënat (të gjeturat) duke përdorur fotografi, vizatime, modele dhe metoda të tjera.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Bashkë-veprimi njeri-natyre	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerëson ajrin si burim natyror dhe element i domosdoshëm për jetën. - Identifikon ndotësit kryesorë të ajrit. - Përkruan tokën dhe ujin si burime shumë të rëndësishme natyrore për jetën në mjedis; - Përkruan një mjedis të ndotur dhe të pastër jetësor përmes përdorimit të vizatimeve, fotografive etj. 	<p>29. Ndotja e ajrit</p> <p>30. Uji</p> <p>31. Uji (përsëritje)</p> <p>32. Ndotja e ujit</p> <p>33. Toka</p> <p>34. Ndotësit e Tokës</p> <p>35. Test vlerësues</p> <p>36. Ta ruajmë mjedisin</p> <p>37. Ta ruajmë mjedisin (përsëritje)</p>	9	<p>DRTA</p> <p>Stuhi mendimesh</p> <p>Turi i galerisë</p> <p>Gushëkuqi rrethor</p> <p>Copëza të përziera</p> <p>Teknika e pyetjeve</p> <p>Rrjeti i diskutimit</p> <p>Parashikim me terma paraprakë</p> <p>Imagjinatë e drejtuar</p> <p>Kubimi</p> <p>Shkrim i lirë</p> <p>Pesëvargësh</p> <p>Lexim në dyshe</p> <p>Mësimdhënia reciproke</p> <p>Të nxënësit në bashkëpunim</p> <p>Mbledhja e të dhënave</p> <p>Projekte</p> <p>Eksperimente</p>	<p>Pjesëmarrja në aktivitete</p> <p>Listë kontrolli</p> <p>Semafori</p> <p>Informata kthyese</p> <p>Vlerësimi i ndërsjellë</p> <p>Dy yje, një dëshirë</p> <p>Vëzhgimi</p> <p>Kontrolli para fluturimit</p> <p>Vlerësimi i projekteve</p> <p>Vlerësimi i portfolios</p> <p>Vlerësimi i punës</p> <p>praktike eksperimentale</p>	<p>Gjuhë amtare</p> <p>Ed. fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Jeta dhe puna</p> <p>Arte</p> <p>Çështje ndërkurrikulare</p> <p>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukimi për paqe</p>	<p>Njeriu dhe natyra I</p> <p>Njeriu dhe natyra I - fletore pune (Sh. B. Dukagjimi)</p> <p>Paketa e gjelbër</p> <p>Burime nga interneti (filma, dokumentarë, videoeksperimente, materiale tekstuale, fotografi, programe in-struktive, video etj.), encklopedi, atlase etj.</p>

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Përbërja, vetitë dhe përdorimi i materialeve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon materialet që përdoren në mjedis (ndërtimtari, rroba, vegla, lodra, ushqime).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II.1; II.4; V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Identifikimi i materialeve dhe përbërja e tyre

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon objekte të ndryshme në klasë;
- Zbulon fjalën në bazë të figurave;
- Përcakton objektet në bazë të ndërtimit të tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Lodra plastike, gotë qelqi, ngjyra druri, pako, shami.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematikë, Shkathësi për jetë, Gjuhë amtare (shqipë).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Merret një pako kartoni dhe vendosen brenda saj lodra plastike, një gotë qelqi, ngjyra druri, kapëse metalike, copëza materiali e gjëra të ndryshme që mund të jenë të pranishme në klasë e që janë të përbëra nga lëndë të ndryshme. (Sugjerohet që në klasë të jetë një gotë e mbushur me shkopinj druri, ku secili shkop e ka një emër nxënësi e kështu, në mënyrë rastësore, përzgjidhen disa nga ta për të realizuar aktivitetin.) Nxënësve të përzgjedhur u mbyllet sytë; më pas ata (symbyllazi) duhet t'i vendosin duart në pako dhe t'i prekin objektet për t'i identifikuar ato. Udhëzohen ta përshkruajnë objektin me cilësi të ndryshme, si: objekt i fortë, i lakueshëm, i lehtë etj.

Hapi 2: Bëhet pyetja:

- Nga çfarë janë të ndërtuara objektet përreth nesh?

1.1 IDENTIFIKIMI I MATERIALEVE DHE PËRBËRJA E TYRE

Nga çfarë janë të përbëra gjërat rreth nesh?

Të gjitha gjërat (objektet) rreth nesh janë të përbëra (të ndërtuara) nga materiale të ndryshme. Në figurë mund të shihni objektet që janë të përbëra nga materiale të ndryshme. Ato përdoren në ndërtimtari, si rroba, për vegla pune, lodra, për ushqim etj.



Diskutoni për gjërat (objektet) që gjenden në klasë dhe për përbërjen e tyre.

7

1.1 IDENTIFIKIMI I MATERIALEVE DHE PËRBËRJA E TYRE

Nga çfarë janë të përbëra gjërat rreth nesh?

Të gjitha gjërat (objektet) rreth nesh janë të përbëra (të ndërtuara) nga materiale të ndryshme. Në figurë mund të shihni objektet që janë të përbëra nga materiale të ndryshme. Ato përdoren në ndërtimtari, si rroba, për vegla pune, lodra, për ushqim etj.










Diskutoni për gjërat (objektet) që gjenden në klasë dhe për përbërjen e tyre.

7

Diskutohet për disa minuta, pastaj kalohet në aktivitetin e radhës, përmes të cilit nxënësit do ta gjejnë titullin e mësimit duke zhvilluar ushtrime të ndryshme.


Hapi 3: Përgatitet një fletë pune me ushtrime rreth mësimit (material shtesë). Fillohet me fjalën sekrete, si në foton në vijim. Fjala zbulohet duke e shënuar shkronjën e parë të figurës poshtë.

			
M	A	T	E
			
R	I	A	

U shpjegohet nxënësve se gjithçka rreth nesh është materie dhe që secili trup është i ndërtuar nga një materie e caktuar. Hapet libri në faqen 7, vrojtohet figura dhe diskutohet rreth saj.

Hapi 4: Në fletën e punës, në detyrën 2, nxënësit do të kenë një ushtrim që ka të bëjë me klasifikimin e materieve, si: plastikë, dru, metal. Ata do të vizatojnë nga tri objekte për secilin.

Puna do të realizohet në dyshe me shoqen a shokun e bankës.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, identifikimin e objekteve sipas materies, gjetjen e fjalëve; punën në dyshe.

Detyrë:

Vizaton tri objekte dhe tregon prej cilës materie janë ndërtuar.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Përbërja, vetitë dhe përdorimi i materialeve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Emërton materiale me origjinë natyrore dhe të krijuara nga njeriu.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.2; III.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Origjina e materialeve.

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Klasifikon produktet sipas ndërtimit;
- Përcakton origjinën e materialeve të dhëna;
- Dallon materialet natyrore nga ato të krijuara nga njeriu.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, lodra, lapsa, gotë qelqi, pambuk.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematikë, Shkathësi për jetë, Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Ora mësimore fillon me një përsëritje nga mësimi i kaluar, duke u parashtruar nxënësve disa pyetje, si:











- Nga çfarë janë të ndërtuara të gjitha gjërat rreth nesh?
- Cilat janë disa nga materialet e ndryshme nga të cilat ndërtohen gjësendet a objektet?

Me këtë rast, nxënësit do ta rikujtojnë materien dhe llojet e saj, si: drurin, plastikën, qelqin etj.

Hapi 2: Ftohen nxënësit të hapin fletoren e punës. Plotësohen detyrat sipas udhëzimeve, duke bashkëpunuar me ta.

1.2 ORIGJINA E MATERIALEVE











Materialet mund të jenë me origjinë natyrore ose të krijuara nga njeriu.

Materiale me origjinë natyrore	Materiale të krijuara nga njeriu
Rëra 	Tulla 
Pambuku 	Këpuca 
Guaska e kërmillit 	Balona 
Boça e pishës 	Vazoja 
Druri 	Celiku 

Dallo gjërat në shkollë që janë të përbëra nga materialet me origjinë natyrore dhe ato të krijuara nga njeriu.

1.2 ORIGJINA E MATERIALEVE

Materialet mund të jenë me origjinë natyrore ose të krijuara nga njeriu.

Materiale me origjinë natyrore	Materiale të krijuara nga njeriu
Rëra 	Tulla 
Pambuku 	Këpuca 
Guaska e kërmillit 	Balona 
Boça e pishës 	Vazoja 
Druri 	Celiku 

Dallo gjërat në shkollë që janë të përbëra nga materialet me origjinë natyrore dhe ato të krijuara nga njeriu.

8

Hapi 3: Vendosen në tabelë disa fotografi të pemëve, të rërës, të gurëve. Në të njëjtën kohë nxënësit do t'i kenë ato edhe në fletën e tyre të punës (material shtesë). Prandaj mund t'u parashtrohen pyetje të tilla, si:

- Ku i shohim këto materiale?

Një nga përgjigjet e mundshme mund të jetë:
Në natyrë.

Roli i mësuesit është edhe t'i drejtojë drejt kësaj përgjigjeje. Më pas vendosen foto të tjera, si lodra, gotë qelqi, laps.

Më pas pyeten nxënësit:

- Kush mund të jetë krijuesi i këtyre gjërave? Nxënësit do të japin përgjigje të ndryshme dhe me ndihmën e mësuesit do të kuptojnë që ndërtohen nga njeriu dhe nuk gjenden të gatshme në natyrë.

Hapi 4: Udhëzohen nxënësit t'i hapin librat dhe ta vështrojnë ndarjen e materialeve nga ato që kanë origjinë natyrore dhe ato të krijuara nga njeriu. U shpjegohet nxënësve fjala "origjinë" me sinonime të tjera më të kuptueshme për ta, p.sh., me fjalën "prejardhje", ku kuptimi i saj është prej nga vjen dikush ose diçka, duke theksuar që ne vijmë nga prindërit tanë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në mënyrën e klasifikimit të produkteve, përcaktimin e origjinës së materialeve dhe dallimin e tyre.

Detyrë:

Në një karton ngjet dy materiale natyrore dhe dy të krijuara nga njeriu.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Përbërja, vetitë dhe përdorimi i materialeve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan vetitë fizike të materialeve të jetës së përditshme (fleksibiliteti, transparenca, fortësia, vetia magnetike)

Grupon objektet sipas materialeve që i përbëjnë ato (tekstil, gomë, metal, plastikë, qelq, dru, argjilë)

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.2; III.7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vetitë e materies

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Veçon objektet në bazë të origjinës;
- Dallon objektet sipas vetive fizike (fleksibiliteti, transparenca, fortësia, vetia magnetike);
- Përcakton vetitë e objekteve të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Sendet brenda klasës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimitim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Ftohen nxënësit të dalin para klasës. Nxiten të gjejnë sende në klasë që janë të përbëra me materiale me origjinë natyrore dhe ato të krijuara nga dora e njeriut.

Sendet e gjetura klasifikohen në dy banka.

Origjinë natyrore

Pambuku

Rëra - dheu

Nga dora e njeriut

Vazo

Balona

1.3 VETITË E MATERIALEVE

Objektet apo trupat, sipas përbërjes së materialit dhe origjinës, dallohen nga disa veti, si: fleksibiliteti (lakueshmëria), tejdukshmëria, fortësia dhe vetia magnetike.

I lakueshëm - objekti që mund të zgjatet, përkulet, përdridhet me dorë.

I tejdukshëm - objekti nëpër të cilin kalon drita dhe mund të shohësh përtej tij.

I fortë ose butë - objekt i fortë është ai që nuk mund të shtyhet ndërsa i butë kur shtyhet me dorë.

Veti magnetike - kur objekti tërhiqet ose shtyhet.

Shkruaj nën secilin material vetinë që ka.



Aktivitet
Provoni në klasë vetitë magnetike të objekteve.
 Merrni një copë magneti dhe afrojeni te objektet e ndryshme në klasë. Objekti që tërhiqet ose shtyhet, ka veti magnetike. Kurse ai që nuk tërhiqet ose nuk shtyhet, është pa veti magnetike.

1.3 VETITË E MATERIALEVE

Objektet apo trupat, sipas përbërjes së materialit dhe origjinës, dallohen nga disa veti, si: fleksibiliteti (lakueshmëria), tejdukshmëria, fortësia dhe vetia magnetike.

I lakueshëm - objekti që mund të zgjatet, përkulet, përdridhet me dorë.

I tejdukshëm - objekti nëpër të cilin kalon drita dhe mund të shohësh përtej tij.

I fortë ose butë - objekt i fortë është ai që nuk mund të shtyhet ndërsa i butë kur shtyhet me dorë.

Veti magnetike - kur objekti tërhiqet ose shtyhet.

Shkruaj nën secilin material vetinë që ka.



Aktivitet

Provoni në klasë vetitë magnetike të objekteve.

Merrni një copë magneti dhe afrojeni te objektet e ndryshme në klasë. Objekti që tërhiqet ose shtyhet, ka veti magnetike. Kurse ai që nuk tërhiqet ose nuk shtyhet, është pa veti magnetike.

9

Hapi 2: Udhëzohen nxënësit të përshkruajnë sendet e gjetura.

Ja disa shembuj të mundshëm:

Balona ka origjinë nga dora e njeriut, është e butë, ndërron formën, zgjatet, përdridhet.

Pambuku ka origjinë natyrore, është i butë, mund të shtyhet me dorë.

Nga shembujt vihet në përfundim që materialet kanë veti, si: fleksibiliteti – i lakueshëm, transparenca – i tejdukshëm, fortësia – e butë, e fortë dhe vetia magnetike.

Hapi 3: Hapen librat. Përshkruhen ilustrimet në libër dhe vetitë e tyre.

Shkruhet nën secilin material vetia që e ka.



Fleksibile



i fortë



i tejdukshëm



i butë

Hapi 4: Demonstronhet vetia e magnetizimit. Merret një copë magneti dhe afrohet tek objektet e ndryshme në klasë. Objekti që tërhiqet apo shtyhet ka veti magnetike. Kurse ai që nuk tërhiqet apo shtyhet është pa veti magnetike.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në veçimin e objekteve në bazë të origjinës, dallimin e objekteve sipas vetive fizike, si dhe përcaktimin e saktë të vetive të objekteve të dhëna.

Detyrë:

Fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës**Lënda:** Njeriu dhe natyra**Shkalla e kurrikulës:** 1 **Klasa:** I**Tema:** Përbërja, vetitë dhe përdorimi i materialeve**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përshkruan përdorimin e materialeve të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.2; III.7.**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore:** Përdorimi i materialeve**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon vetitë fizike të sendeve;
- Përshkruan përbërjen e tyre;
- Klasifikon sendet sipas kriterit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kukulla, top, gomë, shishe plastike, kapelë, çorape, libër, lapsa, qese, lugë druri.**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS****Hapi 1:** Në një kuti të mbyllur janë vendosur sende të ndryshme si: kukulla, top, gomë, shishe plastike, kapelë, çorape, libër, lapsa, qese, lugë druri, letër, etj.

Ftohen nxënësit të tërheqin nga një send dhe, pa e parë, e përshkruajnë atë.

Pyeten:

- Çfarë mund të jetë?
- A është i fortë apo i butë?
- Çfarë materiali është?

Ja disa përgjigje të mundshme: (çorapet) atë që preka është material i butë, copë, shtypet lehtë etj.

1.4 PËRDORIMI I MATERIALEVE

Ne përdorim materiale të ndryshme për të krijuar gjëra që na duhen në jetën e përditshme. Gjërat që përdorim mund të jenë të përbëra vetëm nga një material apo prej shumë materialeve.

Për ndërtimin e karriges në figurë, është përdorur vetëm druri si material. Për të ndërtuar këtë laps në figurë, është përdorur druri, grafiti, metali, goma dhe ngjyra.



Gjërat (objektet) e ndërtuara nga materialet mund t'i grupojmë sipas llojit të materialit të vetëm që ndërtohen. Ato i quajmë, për shembull, gjëra prej metali, gome, druri, plastike, qelqi, letre, tekstili, argjile etj. Këto gjëra përdoren për nevoja të ndryshme në jetën e përditshme.





Gjërat ndërtohen dhe nga materiale të ndryshme, siç janë: druri dhe metali apo plastika dhe metali, por edhe nga më shumë materiale.

Dallo gjërat që gjenden në klasë dhe ato në çantat tuaja që janë ndërtuar vetëm prej një materiali dhe ato prej shumë materialeve. Diskutoni për përdorimin e tyre.

Hapi 2: Pas përshkrimit, sendet e tërhequra, i vendosim mbi një bankë. Pyeten:

- Nga cili material është e përbërë kukulla? (kukulla është e përbërë nga dy materiale, pëlhurë dhe plastikë).
 - Nga cili material është e përbërë luga e drurit? (luga e drurit është e përbërë vetëm nga druri).
- Nga ky diskutim vijmë në përfundim që sendet përbëhen nga një e më shumë materiale.

TË NGURTA	TË LËNGËTA	TË GAZTA

Hapi 3: Hapen librat. Diskutohen ilustrimet e paraqitura në libër. Përshkruhet përbërja e tyre.

Karriga – nga druri;

Lapsi – druri, metali, goma;

Banka – druri, metali, plastika.

Hapi 4: Nxiten nxënësit të klasifikojnë sendet që kanë, në dy kolona.

Prej një materiali	Prej shumë materialeve

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë, dallimin e vetive fizike të objekteve, përshkrimin e përbërjes së tyre, si dhe klasifikimin sipas kriterëve.

Detyrë:

Në një fletë të bardhë vizaton dy sende të ngurta, dy të gazta dhe dy të lëngëta.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Materialet dhe shndërrimet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Hulumton ndikimin e ujit në lloje të ndryshme të materialeve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.2; III.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndikimi i ujit në materiale të ndryshme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan ilustrimet në libër;
- Tregon ndikimin e ujit në materiale të ndryshme;
- Liston disa rregulla për mbrojtje nga myku dhe ndryshku.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shishe me ujë, gotë qelqi, sheqer, kripë, lugë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxiten nxënësit të marrin pjesë në diskutim. Mbi bankë vendosim një shishe ujë, sheqer, kripë. Shtrohen pyetje:


1. çfarë mendoni se ndodh nëse në shishen me ujë hedhim sheqerin?
2. Po nëse hedhim kripë në të?

Diskutohen përgjigjet e mundshme të nxënësve.

MATERIALET DHE SHNDËRRIMET

1.5 NDIKIMI I UJIT NË MATERIALE TË NDRYSHME

Uji ka ndikim të ndryshëm në materiale të ndryshme. Për shembull, uji ndikon në tretjen e kripës, të sheqerit etj. Uji ndikon edhe në hekur. Nëse hekuri qëndron në lagështi, ai ndryshket. Ka dhe metale ku uji nuk ka ndikim, për shembull, alumini e bakri nuk ndryshken.



Uji ka ndikim në muret e dhomave të shtëpisë. Kur uji rrjedh ose ka lagështi, shkaktohen probleme të shumta në shtëpi. Mund të dëmtohet ngjyra e mureve, të çahen muret, të krijohet myku etj. Të gjitha këto mund të kenë ndikim negativ për shëndetin tuaj. Ka materiale të ndryshme që i përshkon uji, për shembull: letra, sfunjeri etj., si dhe ka materiale që nuk i përshkon uji, siç janë: dorezat e plastikës, çadra, xhami etj.



Diskutoni së bashku me mësuesen/in se çka duhet bërë që të mos krijohet myku në shtëpi.

MATERIALET DHE SHNDËRRIMET

1.5 NDIKIMI I UJIT NË MATERIALE TË NDRYSHME

Uji ka ndikim të ndryshëm në materiale të ndryshme. Për shembull, uji ndikon në tretjen e kripës, të sheqerit etj. Uji ndikon edhe në hekur. Nëse hekuri qëndron në lagështi, ai ndryshket. Ka dhe metale ku uji nuk ka ndikim, për shembull, alumini e bakri nuk ndryshken.



Uji ka ndikim në muret e dhomave të shtëpisë. Kur uji rrjedh ose ka lagështi, shkaktohen probleme të shumta në shtëpi. Mund të dëmtohet ngjyra e mureve, të çahen muret, të krijohet myku etj. Të gjitha këto mund të kenë ndikim negativ për shëndetin tuaj. Ka materiale të ndryshme që i përshkon uji, për shembull: letra, sfungjeri etj., si dhe ka materiale që nuk i përshkon uji, siç janë: dorezat e plastikës, çadra, xhami etj.



Diskutoni së bashku me mësuesen/in se çka duhet bërë që të mos krijohet myku në shtëpi.

12

metale që nuk ndryshken. Muret e ndërtesave, kur ka lagështi, mund të myken. Duhet të keni kujdes, myku ndikon negativisht në shëndetin e njeriut. Gjatë pastrimit, duhet të përdorimin doreza gome.

Hapi 4: Nxiten nxënësit të nxjerrin disa rregulla për pastrimin e mykut dhe të ndryshkut, parandalimin e krijimit të tyre.

Rregullat shënohen në tabelë. Ja disa shembujt të mundshëm:

- Mbjaj doreza gome në duar gjatë pastrimit të mykut;
- Gjërat e ndryshkura të mos kapen me duar të pambrojtura.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e ilustrimeve në libër, tregimin e ndikimit të ujit në materiale të ndryshme, si dhe listimin e këshillave për mbrojtje nga myku e ndryshku.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Hapi 2: Demosntrohet tretja e sheqerit dhe kripës në ujë.

Marrim shishen e ujit, në të hedhim sheqerin dhe e përziejmë më një lugë për disa sekonda. Shohim që sheqeri është tretur.



Njëjtë veprohet edhe me kripën.



Nga demonstrimi vihet në përfundim se uji ndihmon që sheqeri dhe kripa të treten në të.

Hapi 3: Hapen librat. Përshkruhen ilustrimet e paraqitura.

- Çfarë ka ndodhur me metalin?
- A mendoni që uji ka ndikuar në ndryshkjen e tij? Pse?

Gjatë diskutimit theksohet që uji ka ndikim në metale. Nëse metali, hekuri, qëndron në lagështi, ai ndryshket. Alumini dhe bakri janë

metale që nuk ndryshken. Alumini dhe bakri janë

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I
Tema: Përbërja, vetitë dhe përdorimi i materi-aleve

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përshkruan ndikimin e ngrohjes dhe të ftohjes në lëndë të ndryshme (çokollatë, ujë, akullore, vezë).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.2; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
 Ndikimi i ngrohjes dhe i ftohjes në materiale të ndryshme.

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon temperaturën e ulët nga ajo e lartë;
 - Përcakton ndikimin e temperaturës në lëndën e caktuar;
 - Zgjedh temperaturën ndikuese në shndërrimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Ora fillon duke i pyetur nxënësit:

- Gjatë verës, kur jeni duke ngrënë akullore, nëse nuk e hani menjëherë, çfarë ndodh me të? Përgjigjja e pritshme është që akullorja do të do të shkrihet.

Më pas vazhdohet me pyetjet, si:

- Pse shkrihet ajo?
- Ku duhet ta lëmë atë të mos shkrihet?

Pyetje të tjera të ngjashme bëhen varësisht nga drejtimi i diskutimit në klasë. Kështu nxënësit fillojnë ta kuptojnë rolin e temperaturës së ulët dhe të lartë.

Hapi 2: Në tabelë vendosen fotografi të tharësës së flokëve, të një frigoriferi dhe të një shporeti elektrik.

1.6 NDIKIMI I NGROHJES DHE I FTOHJES NË MATERIALE TË NDRYSHME

Materiali mund ta ndryshojë formën.
 Kur është ftohtë, uji ngrin dhe kalon në akull.
 Ngrirje do të thotë kalim nga gjendja e lëngët në të ngurtë.



Kur akulli ngrohet, ai shkrihet.
 Shkriroje do të thotë kalim nga gjendja e ngurtë në të lëngët.



Kur uji ngrohet, ai avullon.
Avullim do të thotë kalim nga gjendja e lëngshme në të gaztë.



Edhe çokollata, edhe akullorja kur ngrohen, shkrihen.



14

Më pas bëhen pyetje, si:

- Çfarë roli kanë mjetet e paraqitura në tabelë?
- Pse sendet që vendosen në frigorifer ftohen?
- Çfarë mund të vendoset mbi shporet elektrik?
- Nëse uji vlon mbi zjarr, çfarë do të çlirohet mbi tenxhere?



Hapi 3: Vendosen 4-5 fotografi të sendeve të ndryshme në një skaj të tabelës. Nxënësit duhet t'i afrojnë pranë mjetit të duhur ku veç i kemi në tabelë, me anë të të cilave, nga temperatura që ata kanë, trupat pësojnë ndryshime, p.sh., një vajzë me flokë të lagur që duhet të qëndrojë pranë tharëses elektrike, copëza akulli pranë frigoriferit. (Shikoj figurat te hapi 2.)

Hapi 4: Zhvillohet aktiviteti nga libri. Merr një copë çokollate dhe vendose në një dorë. Mbuloje me dorën tjetër. Mbaj duart e bashkuara për 2 minuta. Çfarë ka ndodhur me çokollatën? Pse?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohet angazhimi gjatë orës, saktësia në dallimin e temperaturës dhe ndikimi i saj në lëndë të ndryshme.

Detyrë:

Vendos një shishe ujë në frigorifer (të cilën e lë tërë natën) dhe me ndihmën e prindërve zien një çaj dhe vëzhgon se ç'ndodh.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Vetja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon nevojat e ndryshme për jetë të njeriut dhe të kafshëve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.6; II.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trupi im

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton pjesët e jashtme të trupit;
- Shpjegon ndërlydhjen e pjesëve të trupit në një sistem;
- Krijon trupin e njeriut duke bashkuar pjesët e ndara të trupit në një tërësi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kukulla, makina, prerje të pjesëve të jashtme të trupit, vizatim i trupit të njeriut me karton, brumë, letra, gërshtë, maska.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë muzikore, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Mësimi fillon me një këngë të mësuar për pjesët e trupit. Këndimi shoqërohet me lëvizje duke i prekur pjesët e trupit që përmenden në këngë. Hapen librat në faqen 17 dhe së bashku me nxënësit emërtohen pjesët e trupit të paraqitura me anë të vizatimit.

Hapi 2: Paraqitet para nxënësve një makinë lodër dhe një kukull.

Emërtohen pjesët përbërëse të tyre, duke theksuar se bashkimi i gjitha këtyre pjesëve krijon një sistem. Në këtë sistem secila pjesë e trupit e ka rolin e saj dhe për të funksionuar duhet të vepronjë bashkë.

2.1 PJESËT E TRUPIT DHE FUNKSIONI I TYRE

Trupi im - është i përbërë nga pjesë të ndryshme. Secila na duhet për diçka. Të gjitha pjesët punojnë së bashku për ta mbajtur trupin të gjallë dhe të shëndetshëm. Ato na ndihmojnë t'i plotësojmë nevojat tona. Trupi ynë ka nevojë për ushqim, ujë, ajër dhe për hapësirë.

Hunda dhe mushkëritë na ndihmojnë që të marrim ajër.

Goja, dhëmbët dhe lukthi na ndihmojnë që të ushqehemi.

Muskujt dhe eshtrat na ndihmojnë të lëvizim.

Flokët
Syri
Hunda
Goja
Qafa
Krahu
Dora
Këmba
Shputa

Ndahuni në dy grupe. Njëri grup le t'i emërtojë pjesët e kokës, ndërsa grupi tjetër pjesët e tjera të trupit. Në bashkëpunim me mësuesen/in, trego se për çfarë të shërben secila.

17

2.1 PJESËT E TRUPIT DHE FUNKSIONI I TYRE

Trupi im - është i përbërë nga pjesë të ndryshme.

Secila na duhet për diçka.

Të gjitha pjesët punojnë së bashku për ta mbajtur trupin të gjallë dhe të shëndetshëm.


Ata na ndihmojnë t'i plotësojmë nevojat tona.

Trupi ynë ka nevojë për ushqim, ujë, ajër dhe për hapësirë.

Hunda dhe mushkëritë na ndihmojnë që të marrim ajër.

Coja, dhëmbët dhe lukthi na ndihmojnë që të ushqehemi.

Muskujt dhe eshtrat na ndihmojnë të lëvizim.




Ndahuni në dy grupe. Njëri grup le t'i emërtojë pjesët e kokës, ndërsa grupi tjetër pjesët e tjera të trupit. Në bashkëpunim me mësuesen/in, trego se për çfarë të shërben secila.

17

Hapi 3: Lexohet një tregim me titull "Trupi im". Para se ta lexojmë tregimin udhëzohen nxënësit: *Hapini sytë tuaj, hapini veshët, mbylleni gojën, duart vendosini mbi bankë.* Qëllimi është që nxënësit ta kuptojnë funksionin e pjesëve të trupit. Tregimi mund të krijohet nga mësuesi/ja apo të gjendet në internet. Këshillohen që të kenë kujdes ndaj pjesëve të trupit.

Hapi 4: Kërkohe nga nxënësit t'i përzgjedhin materialet sipas dëshirës për modelimin e trupit të njeriut. Ata përzgjedhin materialet dhe në grupe modelojnë trupin e njeriut duke i bashkuar pjesët e ndara të trupit. Secili grup përzgjedh materiale të ndryshme. Ja disa shembuj që mund t'i aplikoni me klasën tuaj. Sqarim: Mund të porositen fëmijët që materialet të sillen nga shtëpia ose mund të punohen në orën e Edukatës figurative.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e emërimit të pjesëve të trupit dhe modelimin e trupit të tij.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I
Tema: Vetja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Tregon dallimin gjinor të njeriut përmes karakteristikave fizike (femër dhe meshkull).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II.1; II.8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.5; 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Dallimi gjinor (vajzë dhe djalë)

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan tiparet e shokut a shoqes së klasës;
 - Identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis njerëzve;
 - Përcakton veshjet në figurat e dhëna në bazë të gjinisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Figura nga kartoni të vajzave dhe të djemve, veshje të dy gjinive, ngjitës, gërshërë, fletë punuese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Një djalë (Lisi) dhe një vajzë (Era) dalin para klasës dhe nga nxënësit e tjerë kërkohet t'i përshkruajnë ata në bazë të pamjes së jashtme, ndërsa sa u përket interesave dhe dëshirave të tyre ata e përshkruajnë veten secili. Pas përshkrimit fizik të Erës dhe të Lisit nga nxënësit, vazhdojmë me Lisin i cili i tregon lojërat që pëlqen, librat, dëshirat dhe talentet e tij, ngjashëm vepron edhe Era duke i specifikuar talentet, lodrat, kafshët dhe aktivitetin e saj ditor.

Hapi 2: Nëpërmjet Diagramit të Venit gjenden veçoritë e përbashkëta dhe dallimet në mes të Erës dhe të Lisit.



2.2 DALLIMI GJINOR (VAJZË DHE DJALË)

Trupi i vajzës dallon nga trupi i djalit. Ata ndryshojnë për nga forma dhe për nga ndërtimi.



Duke shikuar figurat lart, gjeji dallimet mes trupave. Diskutoni së bashku për ndryshimet që vëreni.


18

Në bazë të përshkrimeve të nxënësve plotësohet diagrami me tiparet e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet dy gjinive.

Arrihet në përfundim se:

“Të gjithë njerëzit janë qenie të gjalla, kanë ngjashmëri, por kanë edhe dallime që e bëjnë të veçantë dhe unik secilin prej nesh. Mirëpo të gjithë kanë të drejta të barabarta.”

Hapi 3: Ndahet klasa në dy grupe ku secili grup pajiset me mjetet e nevojshme për punë. U shpërndahen nxënësve kukulla të të dy gjinive. Ata do t’u vendosin atyre veshjet e përshtatshme. Me anë të teknikës lapsat në mes, përfaqësuesi i grupeve i prezanton kukullat e përfunduara. Kukullat e punuara do t’i përdorin si personazhe në orën e Gjuhës shqipe.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për mënyrën e përshkrimit të tipareve, identifikimin e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet njerëzve dhe për përcaktimin e veshjeve në bazë të gjinisë.

Detyrë:

Me ndihmën e prindërve, shkruan për dallimet fizike mes mashkullit dhe femrës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Vetja ime

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan rëndësinë e higjienës së pjesëve të trupit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; IV.1; V.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1; 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan efektin e sapunit në largimin e mikrobeve;
- Identifikon mjetet e duhura higjienike që përdoren;
- Shpjegon rëndësinë e mbajtjes së higjienës për shëndetin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Sapun të lëngët, enë me ujë, piper të zi, furçë dhëmbësh, krehër, shampo flokësh, prerëse thonjsh, foto të pjesëve të trupit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Eksperiment

Mësimi fillon me një eksperiment të thjeshtë për të demonstruar para nxënësve se si përhapen mikrobet dhe se larja e duarve me sapun është e rëndësishme ngase i largon ato. Më poshtë paraqiten hapat që duhet të ndiqen për të zhvilluar këtë eksperiment.

1. Pajisen nxënësit me një enë me ujë të pastër dhe një enë me sapun të lëngët.
2. Në enën me ujë të pastër hidhet piper (një qese piperi) dhe u tregohet nxënësve se piperi përfaqëson mikrobet.
3. Në enën tjetër hidhet sapun i lëngët.

Nxiten nxënësit të futin gishtin në ujë me piper dhe më pas në sapun. Shpjegohet se kjo përfaqëson



Larja e trupit

Larja e flokëve

Larja e rrobave

Shkruaj në cilat raste duhen pastruar duart. Diskutoni së bashku në klasë me nxënësit e tjerë dhe mësuesen/in se pse pastrohen në ato raste.

20

larjen e duarve të tyre. Kërkohej që përsëri t'i futin duart në enën me ujë dhe piper. Mikrobet do të largohen duke e lënë ujin afër gishtërinjve të pastër.

Pyeten nxënësit:

- Pse në fillim në duart tuaja u mblohdën mikrobet?
- Po pasi i futëm duart në sapun, pse u larguan ato nga duart tuaja?
- A e duan mikrobet sapunin? Pse?

Nxirret përfundimi se për t'i larguar mikrobet dhe për të pasur një shëndet të mirë duhet përdorur sapunin.

Hapi 2: Lojë

Vendosen në klasë disa mjete për pastrim dhe figura ku shihen pjesët e trupit që duhet të përdoren. Kërkohej në fillim të gjejnë mënyra "të çuditshme" të pastrimit, duke bërë me pantomima sikur i pastrojnë dhëmbët me sapun, me furçë të dhëmbëve pastrojnë flokët etj. (Krijohet një atmosferë gazmore ku disponohen nxënësit.) Më pas nxënësit në rreth lëvizin derisa të ndalet muzika. Atëherë i marrin mjetet në dorë dhe e gjejnë shokun që ka figurën me pjesën e trupit që duhet të përdoret mjeti për pastrim të asaj pjese.



Hapi 3: Udhëzohen nxënësit t'i hapin fletoret e punës, ku do t'i tregojnë veprimet e tyre ditore për mbrojtjen dhe pastrimin e trupit, si larjen e dhëmbëve, larjen e fytyrës, të duarve etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përshkrimit të efektit të sapunit dhe mirëmbajtjen e higjienës.

Detyrë:

Të lahet një kukull sipas udhëzimeve të mësuara.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Gjallesat dhe rritja e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon nevojat e ndryshme për jetë të njeriut dhe të kafshëve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3; II.6; II.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.1; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ngjashmëritë dhe dallimet mes qenieve të gjalla

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon karakteristikat themelore të gjallesave;
- Klasifikon sendet e mjedisit të tij në të gjalla dhe jo të gjalla;
- Përshkruan nevojat jetësore të gjallesave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi të gjallesave dhe gjërave jo të gjalla, album, enciklopedi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Pyeten nxënësit: Si quhen prindërit tuaj?

Le të kuptojnë se njerëzit vijnë nga paraardhësit e tyre - prindërit. Gjithashtu edhe se këlyshët e kafshëve që mbajnë në shtëpi kanë një nënë dhe baba. Paraqiten fotografi të gjallesave dhe jogjallesave. Kërkohet nga nxënësit të emërtojnë figurat e paraqitura dhe të përmendin gjërat e zakonshme që shohin në shtëpi dhe në shkollë. Le të kuptojnë se gjërat që mund të rriten, lëvizin dhe ushqehen quhen gjallesa, ndërsa të tjerat që nuk mund të marrin frymë ose të rriten quhen gjëra jo të gjalla.

Hapi 2: U shpërndahen në grupe figura, si: qeni, makina, lulja, uji, fëmija, veza, dielli dhe toka.

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe për t'i klasifikuar këto figura në: të gjalla dhe jo të gjalla.

Ndihmohen që të japin arsyet pse i klasifikojnë ato si të gjalla dhe jo të gjalla dhe ndërlidhjen mes tyre.

2.4 NGJASHMËRITË DHE DALLIMET MES QENIEVE TË GJALLA

Qeniet e gjalla rriten, ndryshojnë dhe lënë pasardhës. Qeniet e gjalla janë të ndryshme.
 Bimët, kafshët dhe njerëzit janë qenie të gjalla. Për të jetuar, atyre u nevojitet ushqim, ujë, ajër dhe hapësirë. Bimët, kafshët dhe njerëzit dallojnë sipas formës, madhësisë, veprimeve etj.



bimë



kafshë



njeri

2.4 NGJASHMËRITË DHE DALLIMET MES QENIEVE TË GJALLA

Qeniet e gjalla rriten, ndryshojnë dhe lënë pasardhës. Qeniet e gjalla janë të ndryshme.

Bimët, kafshët dhe njerëzit janë qenie të gjalla. Për të jetuar, atyre u nevojitet ushqim, ujë, ajër dhe hapësirë. Bimët, kafshët dhe njerëzit dallojnë sipas formës, madhësisë, veprimeve etj.



bimë



kafshë



njeri

21

Gjallesa	Jo të gjalla
qeni	makina

Nxirren përfundimet:

1. Të gjitha gjërat në botë ndahen në të gjalla dhe jo të gjalla.
2. Të gjitha gjallesat rriten, ushqehen dhe lënë pasardhës.
3. Të gjitha gjallesat janë të rëndësishme dhe duhet të trajtohen mirë.

Hapi 3: Pyeten nxënësit:

Fara e fasules është e gjallë apo jo e gjallë? Mbahen shënime për përgjigjet. Udhëzohen të ndjekin hapat e një eksperimenti për të nxjerrë përfundime lidhur me pyetjen e drejtuar.

1. Vendosen dy shtresa leshi ose pambuku në një kapak plastik;
2. Vendosen disa nga farat tuaja midis dy shtresave të pambukut ose leshit;
3. Hidhet ujë mbi farat. Ujitet pambuku ose leshi sa për të lagur, por të MOS teprohet, NUK duhet të ketë ujë mbi anët e kapakut sepse fara “do të mbytet”.

4. Vendosen farat tuaja në një vend të ngrohtë pranë një dritareje.
5. Ujiten farat sa herë që vërehet se leshi i pambukut është pothuajse i thatë, por duhet bërë kujdes që të mos “mbyten” farat! Qëllimi i këtij eksperimenti është të kuptojnë nxënësit që gjallesat për t'u rritur kanë nevojë për ushqim, ajër dhe dritë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrje aktive gjatë diskutimit, për klasifikimin e saktë të gjallesave dhe për përshkrimin e nevojave jetësore të tyre.

Detyrë:

Krijon një album të thjeshtë dhe kontrollon përparimin e farave gjatë ditëve në vijim. Vizaton si duket fara ditën e parë, si duket fara pas disa ditësh, cilët faktorë i kanë ndihmuar të ringjallet.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Gjallesat dhe rritja e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron nevojat e rritjes së bimëve për dritë dhe ujë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.6; II.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.1; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bimët

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan rritjen dhe zhvillimin e bimëve;
- Nxjerr përfundime nga vëzhgimi i eksperimentit për zhvillimin e bimëve;
- Identifikon pjesët kryesore të bimës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Mjedis i jashtëm, bimë mjekuese, fotografi të shtypura (të printuara) të pjesëve të bimës, fletë pune të përgatitura.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit të përshkruajnë eksperimentin e kryer me fasule. Tregojnë se si ka ndryshuar fasulja kur është vendosur në vend të ngrohtë dhe është ujitur.


Pyeten ata:

- Si ka qenë fasulja në fillim?
- Çfarë bëri që fasulja të ringjallet?
- A ishte i saktë parashikimi juaj?


Përshkruajnë eksperimentin e kryer në orën e kaluar, tregojnë rezultatet dhe theksohen nevojat jetësore të gjallesave, si: *uji, ajri dhe ushqimi*.



Bimë ka në të gjitha vendet e botës.
Disa jetojnë në ujë, disa në toka të lagështa e të tjerat në toka të thata.



Bimë të ujërave



Bimë të vendeve të thata



Bimë të tokës

23

Hapi 2: Nxiten nxënësit të parashikojnë se çfarë do të ndodhë me fasulen në ditët në vazhdim.

Regjistrojnë parashikimet e tyre.

Me bimët e mbledhura në oborrin e shkollës, nxënësit do të përshkruajnë atë që shohin, duke i emërtuar pjesët kryesore të bimës dhe ndërlidhjen e pjesëve të saj. Pas rrënjës vjen kërcelli, i cili ka gjethë etj. Duhet bërë kujdes gjatë mbledhjes së bimëve; të merren bimët me rrënjë.



Udhëzohen nxënësit të mbledhin bimë mjekësore për të mos e dëmtuar mjedisin përreth shkollës.

Diskutohet për mbrojtjen e mjedisit dhe rëndësinë e bimëve për njerëzit dhe kafshët.

Hapi 3: Nxënësit punojnë në fletën punuese të përgatitur. Do të shkruajnë pjesët e bimës në

vendet e zbrazëta, duke u mbështetur te figurat e paraqitura në fletë. Ndihmohen ata që kanë vështirësi dhe varësisht nga nevoja mund të përshtatet fleta punuese sipas niveleve të nxënësve, p.sh., ndonjë nxënës vetëm mund ta ngjyrosë lulen, tjetri ta plotësojë vetëm kërkuesën e parë, të tjerët në tërësi fletën. Pas plotësimit, nxënësit prezantojnë punimet e tyre, përmirësojnë gabimet eventuale dhe vlerësohen për punën e kryer.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përshkrimin e rritjes dhe të zhvillimit të bimës dhe të pjesëve të bimës, saktësinë në nxjerrjen e përfundimeve nga eksperimenti dhe identifikimin e pjesëve të bimës.

Detyrë:

Mbjell fasulen e ringjallur në një vazo të mbushur me dhe i vizaton ndryshimet.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Gjallesat dhe rritja e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon nevojat e ndryshme për jetë të njeriut dhe të kafshëve

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.6; III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 1.6; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kafshët

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon nevojat jetësore të qenieve të gjalla;
- Përshkruan kafshën e preferuar ose kafshën që e mban në shtëpi;
- Klasifikon kafshët sipas mjedisit në të cilin jetojnë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, fletë punuese të përgatitura, projektor, laptop, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Bëhet përsëritje e njësive të mësuara për qeniet e gjalla dhe nevojat jetësore të tyre.

Shtrohen pyetjet për diskutim:

- Cilat janë nevojat e domosdoshme të qenieve të gjalla për jetesë?
- Kush bën pjesë në qeniet e gjalla?
- Keni kafshë në shtëpi? Përshkruaje si duket, me çka ushqehet, cilat lojëra i luani bashkë?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë. Fjala “kafshë” rrethohet dhe nxiten ata të përcjellin me vëmendje një videoincizim nga interneti për kafshët, nevojat e tyre, ushqimin dhe vendin ku jetojnë.

Videoja gjendet në: <https://www.youtube.com/hashtag/animalneeds>.


2.5 KAFSHËT DHE NJERËZIT

Kafshët dhe njerëzit janë qenie të gjalla. Ato kanë nevojë për ushqim, për ujë, për ajër, për hapësirë, strehë dhe gjumë. Strehë është vendi ku kafshët strehohen dhe janë të sigurta. Kafshët nuk prodhojnë ushqim vetë sikurse bimët. Ato e marrin të gatshëm nga bimët dhe kafshët e tjera.



Çerdhja është streha e zogut.

Kafshët jetojnë në hapësira të ndryshme; disa jetojnë në tokë, të tjerat jetojnë në ujë.



Kafshë e ujit



Kafshë e tokës

Kafshët kanë pjesë të ndryshme të trupit, të cilat u ndihmojnë t'i plotësojnë nevojat e tyre.



Disa kafshë përdorin sytë dhe hundën për ta gjetur ushqimin.



Sytë, veshët dhe hunda u ndihmojnë kafshëve ta ndiejnë rrezikun.



Këmbët dhe krahët u ndihmojnë t'i shmangen rrezikut.

Diskutoni dhe shkruani për kafshët që i njihni, të cilat lëvizin duke ecur, fluturuar, notuar.

25

Hapi 2: Prezantohet videoja e përzgjedhur. Nxënësit e përcjellin me vëmendje.

Më pas nxiten të parashtrajnë pyetje lidhur me videon e prezantuar, si dhe t'i emërtojnë kafshët e ndryshme që njihin. Theksohet se kafshët duhen mbrojtur, ushqyer dhe trajtuar me kujdes.

Hapi 3: Para nxënësve paraqiten dy mjedise jetësore: mjedisi ujor dhe mjedisi tokësor. Nxënësit do të emërtojnë kafshët në fletë punuese dhe do të vendosin secilën prej tyre në mjedisin ku jeton. Pas përfundimit, jepen arsyet e tyre për këtë klasifikim.



Fig.1 Mjedisit tokësor



Fig.2 Mjedisit ujor

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e kafshëve, nevojat jetësore dhe klasifikimin e tyre sipas mjedisit ku jetojnë.

Detyrë:

Vizaton kafshën e vet të preferuar ose që e mban në shtëpi (fletore pune).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Gjallesat dhe rritja e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon nevojat e ndryshme për jetë të njeriut dhe të kafshëve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4; II.1; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2;2.2; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Njerëzit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Diskuton ngjashmëritë dhe dallimet në mes të njerëzve dhe të kafshëve;
- Identifikon ndryshimet në mes të njerëzve dhe të kafshëve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto të printuara të kafshëve, fletë të bardha.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Globalizimi dhe ndërvarësia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Meqenëse në orët e kaluara është mësuar për të gjitha qeniet e gjalla dhe nevojat jetësore të tyre, në këtë orë mësimore do të gjenden dallimet dhe ngjashmëritë midis kafshëve dhe njeriut.

Në fillim të orës paraqitet një video e marrë nga YouTube, e cila mund të paraqitet pa zë dhe komentohet nga mësuesi/ja në shqip (shih vegëzën më poshtë).

<https://www.youtube.com/watch?v=O1HHufG4f9U>

Hapi 2: Pas përfundimit të videos, bashkë me nxënësit, plotësohet tabela me dallimet dhe ngjashmëritë midis njerëzve dhe kafshëve.





Njerëzit janë qenie të gjalla me vetëdije.
Sikurse edhe gjallesat e tjera, njerëzit kanë nevojë për ushqim, ujë, ajër, për hapësirë, strehë dhe veshmbathje.
Streha është shtëpia në të cilën jetojmë.



Diskutoni së bashku me nxënësit e tjerë dhe mësuesen/in se pse na duhet veshmbathja.

26



Hapi 3: Hapen librat (fq. 26), ku diskutohen nevojat e domosdoshme të njeriut për jetesë, si: vendstrehimi, ushqimi, uji, ajri dhe hapësira. *Theksohet: Të gjitha gjërat në klasë janë të ndërtruara nga njeriu, i cili, me mendjen dhe punën e tij, e ka ndryshuar mënyrën e jetesës (botën), duke e bërë atë më të lehtë për veten.*

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe krahasimin e njerëzve dhe të kafshëve, ngjashmëritë dhe dallimet.

Detyrë:

Bën krahasimin mes njeriut dhe kafshëve të tjera, i paraqet përmes vizatimit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Gjallesat dhe rritja e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon mjediset jetësore të qenieve të gjalla.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7. IV.6; V.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.1; 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Mjediset jetësore të qenieve të gjalla

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon mjediset jetësore;
- Përcakton kafshët që jetojnë në ato mjedise;
- Përshkruan mjediset e ndryshme jetësore, duke u bazuar në kafshët që jetojnë në to.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi të printuara të mjediseve jetësore, fotografi të kafshëve, fletë punuese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Vendosen në tabelë foto të mjediseve jetësore, si p.sh.: lumi, pylli, oqeani, kënetat, shtëpia, ferma dhe pema.

Emërtohen mjediset jetësore disa herë me nxënësit dhe shpjegohet që mjedisi jetësor është shtëpia e kafshëve, e bimëve dhe e njerëzve. Ai duhet të mbahet pastër, të mbillet me pemë dhe të mos dëmtohet, sepse rrezikon shëndetin tonë dhe të të gjitha qenieve të gjalla.

Hapi 2: Paraqiten fotografi të kafshëve dhe kërkohet nga nxënësit t'i emërtojnë ato. Fillon diskutimi me fotografinë që paraqet lopën.




Nga mjedisi, qeniet e gjalla marrin ushqimin, ujin dhe ajrin. Toka dhe uji paraqesin mjedisin jetësor. Bimët dhe kafshët jetojnë në mjedise të ndryshme. Disa jetojnë në tokë, disa në ujë, kurse disa të tjera jetojnë edhe në tokë, edhe në ujë.

Mjedis ujor



Mjedis tokësor



Bashkëbisedoni me mësuesen/in për mjedisin më të afërt tokësor që keni, për shembull, ndonjë pyll, mjedis ujor (ndonjë lumë apo liqen). Pastaj shkruani llojet e bimëve dhe të kafshëve që jetojnë në të.

28

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në dallimin e mjediseve jetësore, përcaktimin e kafshëve në mjedisin e tyre dhe përshkrimin e këtyre mjediseve.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Pyeten nxënësit:

- Ç'është kjo?
- A e keni parë lopën në oqean apo në kënetë?
- Ku jeton pra lopa?

Vendoset bashkë me nxënësit lopa në fermë.

Paraqitet fotoja e ariut dhe parashtrohen pyetje të tilla, si:

- E njihni këtë kafshë?
- Ku jeton ariu?
- Jeton në shtëpi?
- Po në oqean?

Vendoset bashkë me nxënësit ariu në pyll. Kështu vazhdohet dhe për zogun, bretkosën, qenin dhe macen. Shkruhen në tabelë bashkë me nxënësit dhe emërtohen disa herë.

Hapi 3: U shpërndahen nxënësve fletë punuese të përgatitura ku kërkohet të shkruajnë mjedisin jetësor në të cilin jetojnë kafshët e ndryshme. (Shih fletën më poshtë.)

Shkruhet në tabelë bashkë me nxënësit, duke iu përshtatur fletës punuese.

Peshku jeton në _____ ose _____.

Bretkosa jeton në _____.

Ariu jeton në _____.

Qeni dhe macja jetojnë në _____.

Lopa dhe pula jetojnë në _____.

Zogu jeton në _____.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I
Tema: Emërtimet për pozitën e trupave, sasinë dhe llojet e materialeve

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Cakton objekte dhe trupa që shprehin kuptimet: i madh, i vogël, i rëndë, i lehtë etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3 II.1, II.4

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.4

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vetitë fizike të trupave

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon trupat e dhënë sipas formës, madhësisë dhe sasisë;
 - Përshkruan ilustrimet e paraqitura në libër;
 - Lidh objektet me vetitë fizike të tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Petëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Gjuhë shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nga nxënësit kërkohet të grupojnë trupat (petëzat) e dhënë sipas madhësisë dhe formës që kanë.

- Çfarë forme kanë trupat?
- A dallojnë trupat nga njëri-tjetri?

Emërtohen trupat sipas formës (ylli, katrore, rrethi, vezake) dhe madhësisë (e vogël, e madhe). Gjenden trupa në klasë që kanë formën e yllit, të katrorit dhe të rrethit.

Hapi 2: Udhëzohen nxënësit të shikojnë ilustrimet e paraqitura në libër dhe, më pas, përshkruajnë me fjalë atë çfarë shohin.



Veti e trupave është edhe sasia; disa trupa kanë sasi të vogël, disa kanë sasi më të madhe.

E lehtë E rëndë

Pak Shumë

Disa trupa janë të lehtë, disa të rëndë.

E ftohtë E nxehtë

Disa janë të nxehtë, disa janë të ftohtë.

I ndritshëm Më pak i ndritshëm

Disa janë të ndritshëm, të tjerët më pak të ndritshëm.

Trupi i lëmuar Trupi i vrazhdë

Disa trupa janë të vrazhdë, disa të tjerë janë të lëmuar.

Diskutoni me shokët dhe shoqet në klasë për trupat, duke i dalluar ata në bazë të formës, peshës dhe vrazhdësisë.

31

Diskutohet së bashku me nxënësit duke i treguar vetitë fizike të trupave, që janë: të lehtë, të rëndë, të ftohtë, të nxehtë, të ndritshëm, më pak të ndritshëm etj.

Hapi 3: Njihen nxënësit me kërkesën e detyrës në fletore pune. Orientohen nxënësit që të lidhin objektet me vetitë e tyre fizike. P.sh.:

i shpejtë

e ftohtë

i rëndë

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në vep-
rimentari, saktësinë në dallimin e trupave sipas
formës e madhësisë, përshkrimin dhe lidhjen
midis objektit dhe vetive fizike.

Detyrë:

Vizaton në fletore 3 trupa (objekte) me veti të ndryshme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I
Tema: Emërtimet për pozitën e trupave, sasinë dhe llojet e materialeve

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Cakton objekte dhe trupa që shprehin kuptimet: afër, nën, mbi, larg, majtas etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: : I.3 II.1, II.3, II.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.4, 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pozita e trupave

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan pozitën e trupave në ilustrimin e paraqitur;
 - Përdor në situatë fjalët: para, pas, mbi, nën, afër, larg;
 - Modelon pozita të ndryshme të trupave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, plastelinë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Matematikë, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxiten nxënësit t'i numërojnë vetitë e trupave të mësuar nga njësia e kaluar. Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë. Si mund të jenë trupat për nga madhësia dhe sasia?



3.2 POZITA E TRUPAVE


Pozita tregon vendin ku gjërat janë të vendosura. Ajo ju tregon nëse gjërat janë afër apo larg nga ju. Pozita e trupave mund të përshkruhet përmes fjalëve: **nën, mbi, afër, larg, majtas, djathtas, poshtë, lart.**

Shikoje figurën lart dhe dalloji trupat nga materiali prej të cilit janë ndërtuar. Diskutoni së bashku me nxënësit e tjerë dhe mësuesen/in.

32

3.2 POZITA E TRUPAVE

Pozita tregon vendin ku gjërat janë të vendosura. Ajo ju tregon nëse gjërat janë afër apo larg nga ju. Pozita e trupave mund të përshkruhet përmes fjalëve: **nën, mbi, afër, larg, majtas, djathtas, poshtë, lart.**



Shikoje figurën lart dhe dalloji trupat nga materiali prej të cilit janë ndërtuar. Diskutoni së bashku me nxënësit e tjerë dhe mësuesen/in.

32

Hapi 2: Shtrohet pyetja: Po libri, çfarë vetish ka? Ja një përgjigje e mundshme: *Libri ka shumë faqe, përbëhet nga letra, ka formë drejtkëndëshi etj.*

Vendoset libri mbi bankë dhe parashtrihen pyetjet:

- Ku ndodhet libri?
- Po librat tuaj, ku ndodhen? (Mbi bankë.)

Theksohet: Pozita tregon vendin ku objektet janë vendosur dhe tregon nëse gjërat janë afër apo larg nga ne.

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit ta shikojnë ilustrimin e paraqitur në libër.

Shtrohen pyetje, si:


- Cilët trupa gjenden mbi tavolinë?
- Ku ndodhen librat?
- Afër cilit trup është globi? etj.

Nxënësit përgjigjen duke i përdorur fjalët: **nën, mbi, majtas, larg, afër, djathtas, lart, poshtë.**

Hapi 4: Nxënësit, në fletën A4, modelojnë trupa me plastelinë, duke treguar pozitën e trupave të mësuar: **nën, mbi, para dhe pas.**

Afër figurës shkruajnë se ku ndodhet trupi.

Shembull:



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e dallimit të pozitës së trupave, estetikës në modelimin me plastelinë dhe caktimin e pozitës së trupave.

Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Qetësia, lëvizjet, zëri dhe drita

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon shembuj të gjendjes së qetësisë dhe të lëvizjes së trupave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3 II.1, II.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Qetësia dhe lëvizja e trupave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Ilustron me shembuj trupat në lëvizje dhe qetësi;
- Rendit trupat sipas shpejtësisë së lëvizjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, top, ngjyra, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Matematikë, Edukatë figurative. Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth ilustrimeve të paraqitura me anë të laptopit dhe pyetjeve të shtruara.

A lëvizin trupat? Çfarë i lëviz trupat? Cilët trupa janë në lëvizje?



Ndryshimi i pozitës së një trupi nga një vend në një tjetër quhet lëvizje.

Hapi 2: Diskutohet me nxënësit rreth qetësisë dhe lëvizjes së trupave përmes pyetjeve dhe shembujve të ndryshëm.

3.3 QETËSIA DHE LËVIZJA E TRUPAVE

Disa trupa nuk lëvizin, ata janë në qetësi. Të tjerët ndërrojnë pozitë. Ndryshimi i pozitës së një objekti quhet lëvizje. Shpejtësia tregon se sa shpejt një trup ndërron pozitën. Disa trupa lëvizin ngadalë, të tjerë lëvizin shpejt. Ata mund të lëvizin para, mbrapa ose në formë rrethi.



Secili nga ju kenë genë në parkun e lojërave. Diskutoni së bashku me nxënësit e tjerë dhe shkruaj se cilët trupa aty janë në qetësi e cilët në lëvizje.

3.3 QETËSIA DHE LËVIZJA E TRUPAVE

Disa trupa nuk lëvizin, ata janë në qetësi. Të tjerët ndërrojnë pozitë. Ndryshimi i pozitës së një objekti quhet lëvizje.
Shpejtësia tregon se sa shpejt një trup ndërron pozitën.
Disa trupa lëvizin ngadalë, të tjerë lëvizin shpejt.
Ata mund të lëvizin para, mbrapa ose në formë rrethi.



Secili nga ju keni qenë në parkun e lojërave. Diskutoni së bashku me nxënësit e tjerë dhe shkruaj se cilët trupa aty janë në qetësi e cilët në lëvizje.

33

A mendoni se të gjithë trupat mund të lëvizin? (Jo të gjithë trupat mund të lëvizin, disa janë në një vend.) Kur themi që një trup është në qetësi? (Një trup është në qetësi kur nuk lëviz).

Kërkohen dy nxënës vullnetarë, të cilët do t'ia pasojnë topin njëri-tjetrit.

Kush e lëviz topin? (Nxënësit)

Çfarë lëvizjeje bëri topi? (Lëvizje para, prapa dhe rrethore).

Shfaqet një video ku demonstron lëvizja e trupave, në vegëzën e mëposhtme:

<https://www.youtube.com/watch?v=wMs-r4YgmfV8>

Sqarohet që disa trupa lëvizin ngadalë, të tjerë më shpejt, disa trupa nuk lëvizin, pra janë në qetësi.

Ata mund të lëvizin para, prapa ose në rreth.

Hapi 3: Vështrohet ilustrimi i paraqitur në libër. Kërkohet nga nxënësit ta përshkruajnë lëvizjen e trupave në ilustrim duke i përdorur fjalët: qetësi, lëvizje rrethore, lëvizje para dhe prapa.

Shembull:

Makina me ngjyrë të verdhë lëviz para.

Makina me ngjyrë vjollcë është në qetësi.

Hapi 4: Në fletore pune kërkohet që nxënësit të renditin trupat nga më i ngadalshmi deri te më i shpejti. Pranë trupave vendosin numrat nga 1 deri në 6.

Pas renditjes së trupave, nxënësit ngjyrosin sipas dëshirës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive për ilustrimin me shembuj të trupave në qetësi dhe lëvizje dhe saktësinë e renditjes së trupave për nga shpejtësia e lëvizjes.

Detyrë:

Vazhdojnë ngjyrosjen e figurave në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Qetësia, lëvizjet, zëri dhe drita

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon zëra të ndryshëm që prodhojnë instrumentet muzikore përmes lojërave, vallëzimit, muzikës dhe këngëve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1 III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zëri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon objektet që prodhojnë zë;
- Vizaton objekte a kafshë që ia dëgjojnë zërin;
- Identifikon tingullin e zërit që prodhon objekti a kafsha.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Edukatë muzikore, Edukatë figurative, Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit ta vendosin dorën te fyti dhe të fillojnë të këndojnë sipas dëshirës.

Çfarë po ndieni te dora gjatë këndimit? (Lëvizje, disa dridhje.)

Ato dridhje që ndieni në duar janë të kordave të zërit, të cilat lëshojnë tinguj.

Përmes kujt dëgjohet zëri? (Përmes veshit.)

Cilat objekte lëshojnë zë? (Kitara, pianoja, radioja, zilja etj.)

Hapi 2: Me anë të laptopit lëshohen për disa minuta disa tinguj, si: zëri i bilbilit, zëri i qenit, i lopës, i maces; pianoja, kitara. Nxënësit i imagjinojnë objektet dhe kafshët që lëshojnë zë dhe i vizatojnë në fletën A4.

Hapi 3: Vizatimet e përfunduara i shkëmbejnë me shokun a shoqen e bankës, duke i krahasuar ato. Në të njëjtin rast mund ta plotësojnë vizatimin e njëri-tjetrit nëse ka hapësirë.

3.4 ZËRI

Zërin ju mund ta dëgjoni.
Ai prodhohet nga objektet që dridhen.
Dridhja krijohet kur trupat lëvizin shpejt, prapa dhe para.
Nëse luani me kitarë, dëgjoni zërin e telit që dridhet.
Zëri (tingulli) tingëllon ndryshe në instrumente të ndryshme, sepse ato prodhojnë tinguj me forma dhe madhësi të ndryshme.

Shumë objekte lëshojnë zëra.
Zogu lëshon zë kur këndon, ju, kur flisni apo këndon, lëshoni zë.

Disa zëra janë të lartë, disa të ulët.
Zërat shumë të lartë shkaktojnë zhurmë, p.sh.: boria e veturës dhe zilja e shkollës janë të zhurmshme.

Trego se cilat vegla muzikore di t'i përdorësh.

34

3.4 ZËRI

Zërin ju mund ta dëgjoni.
Ai prodhohet nga objektet që dridhen.
Dridhja krijohet kur trupat lëvizin shpejt, prapa dhe para.
Nëse luani me kitarë, dëgjoni zërin e telit që dridhet.
Zëri (tingulli) tingëllon ndryshe në instrumente të ndryshme, sepse ato prodhojnë tinguj me forma dhe madhësi të ndryshme.



Shumë objekte lëshojnë zëra.
Zogu lëshon zë kur këndon, ju, kur flisni apo këndon, lëshoni zë.



Disa zëra janë të lartë, disa të ulët.
Zërat shumë të lartë shkaktojnë zhurmë, p.sh.: boria e veturës dhe zija e shkollës janë të zhurmshme.



Trego se cilat vegla muzikore di t'i përdorësh.

34

Hapi 4: Nxënësit plotësojnë në fletore pune, ku e rrethojnë emrin e saktë të zërit që prodhohet nga objekti apo kafsha në figurë.

Shembull:



Bubullimë

Cingërimë

Melodi

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, saktësinë e dallimit të objekteve që prodhojnë zë, identifikimin dhe vizatimin e tyre.

Detyrë:

Tregon 4 burime tingujsh që dëgjon në shtëpinë e tij.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Qetësia, lëvizjet, zëri dhe drita

Rezultatet e të nxënit të temës:

Emërton burime të dritës që i njeh nga përditshmëria.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2 IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Drita

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Lidh objektet me dritën që lëshojnë;
- Emërton burime natyrore dhe artificiale të dritës;
- Klasifikon së paku dy burime natyrore dhe artificiale të dritës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Matematikë, Edukatë figurative, Arsimin për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësit në klasë ndahen në 4 grupe. Secili grup zgjedh kryesuesin e grupit, i cili jep përgjigjet e mundshme për lidhjen midis objektit dhe dritës sipas tabelës më poshtë.

A	B	C
Molla	Gjethja	Dardha
Domatja	Bari	Limoni
Trëndafili	Ngjyrë	Banania
E kuqe	E gjelbër	E verdhë
DRITA		



3.5 DRITA

Drita na mundëson të shohim. Drita vjen nga burimet natyrore, por krijohet dhe nga njeriu. Ajo vjen nga Dielli dhe yjet e tjera, por mund të vijë edhe nga qirinjtë dhe llambat e ndryshme.

Burimi natyror i dritës



Burime artificiale të dritës

Disa objekte të tjera e ndalin një pjesë të dritës, për shembull, syzet e diellit.



Drita mund të depërtojë disa objekte, si: xhamin, ujin, ajrin. Disa të tjera ajo nuk mund t'i depërtojë, ato objekte bëjnë hije. Hiça krijohet kur diçka e ndalon dritën.

Diskutoni me shokët, shoqet dhe mësuesen/in se a janë zjarret burime natyrore apo artificiale të dritës. Po vetëtima?

35

Hapi 2: Diskutohet me nxënësit për fjalën “dritë” dhe për burimet e saj.

Shtrohen pyetje:

- Nga e marrim dritën ne?
- Pse na duhet drita?
- Kush bën dritë?
- Cilat janë burimet e dritës?

Ja disa përgjigje të mundshme: *Dritën e marrim nga dielli, llamba, zjarri, yjet, hëna etj.*

Hapi 3. Sqarohet që disa burime vijnë nga natyra, kurse disa të tjera krijohen nga dora e njeriut.

Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se cilat janë burimet natyrore të dritës dhe burimet artificiale të saj. Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.

Burimet natyrore të dritës	Burimet artificiale të dritës
Dielli Hëna Yjet	Llamba Televizori Semafori

Pyetje për diskutim: *Cilat nga burimet e dritës zgjasin më shumë duke dhënë dritë? Dëgjohen mendimet e nxënësve dhe arrihet në përfundimin që dielli dhe hëna janë burime që zgjasin më shumë.*

Hapi 4. Nxënësit i vizatojnë burimet e dritës, që u mësuan gjatë orës mësimore. Pas vizatimit, krahasojnë dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, për saktësinë në lidhjen dhe klasifikimin e burimeve të dritës.

Detyrë:

Plotëson fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënit të temës:

Liston disa mënyra elementare të orientimit në natyrë;

- Përcakton drejtimet kryesore të horizontit (V, L, J, P), duke i bërë të njohur një nga pikat e horizontit (p.sh. Peja gjendet në P, gjen pikat e tjera).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.8, IV.5, V.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6, 2.3, 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vendndodhja dhe orientimi në natyrë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon mënyrat e orientimit;
- Emërton drejtimet kryesore të horizontit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta, kapëse flokësh, magnet, enë qelqi, tapë e shishes.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipë), Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Nxënësve u vendoset harta e Kosovës në tabelë. Nxitet diskutimi duke u bërë disa pyetje, si p.sh.:

- Në cilin planet ndodhemi?
- Në cilin shtet jemi?
- Si quhet vendi ku ju jetoni?




4.1 VENDNDODHJA DHE ORIENTIMI NË NATYRË

Vendi (pozita) na tregon në cilën pozitë gjendet diçka. Ai na tregon edhe pozitën se ku ndodhemi ne. Nëse nga vendi ku jeni, shikoni para në largësi, ju do të vëreni një si vijë që ndan tokën nga qielli. Kjo vijë quhet horizont. Nëse dëshironi të gjeni një vend të caktuar, duhet të lëvizni nga pozita ku jeni. Ju mund të lëvizni në drejtime të ndryshme. Drejtimet kryesore janë: veriu, lindja, jugu dhe perëndimi.




Nëse nga vendi ku jeni, dëshironi të shkoni në shkollë, drejt cilës anë të horizontit duhet të udhëtoni?

Gjetja e drejtimit se ku doni të shkoni quhet orientim. Mund të orientoheni duke përdorur pozitën e Diellit gjatë ditës, apo të yllit polar gjatë natës.




Nëse në mesditë qëndroni me fytyrë të kthyer nga Dielli, atëherë përballë kenë jugun, në anën e majtë lindjen, në anën e djathtë perëndimin, ndërsa prapa jush është veriu.



Për orientim përdoret edhe busulla.

38


Hapi 2: Nxënësit i gjejnë fjalët bazuar në rrokje dhe numra:



Pas formulimit të rrokjeve bëhet përsëritje për katër anët e horizontit dhe mënyrën e orientimit.

Hapi 3: Pyeten nxënësit: Nëse nga vendi ku jeni dëshironi të shkoni në shkollë, në cilën anë të horizontit duhet të udhëtoni?

Ja një përgjigje e mundshme: Unë kur dal nga shtëpia përballë kam diellin dhe e di që pas shtëpisë sime është shkolla.



Pasi bëhet demonstrimi i katër anëve të horizontit, u kërkohet që të formojnë një rreth dhe të bëjnë një eksperiment. Materialet e nevojshme janë: kapëse flokësh, tapë shisheje, magnet, një enë qelqi. Marrim një kapëse flokësh dhe e fërkojmë për një magnet. Më pas marrim një enë dhe hedhim ujë mbi të. Pastaj, në tapën e shishes, e vendosim kapësen e flokut dhe e shikojmë se cilat anë të horizontit do të na i tregojë. P.sh., gjatë demonstrimit, koka e kapëses është në veri apo jug, kurse ana tjetër e kapëses na tregon perëndimin ose lindjen. Aktiviteti vazhdon deri në fund të orës.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, identifikimin e mënyrave të orientimit dhe drejtimit kryesore për saktësinë në përgjigje.

Detyrë:

Plotëson Fletoren e punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Sistemet fizike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon karakteristikat e motit (me shi, diell, stuhi, borë); përshtatja me motin në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1,I.7,IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Moti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon llojet e ndryshme të motit;
- Përshkruan disa mjete që përdoren për matjen e motit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Syze, doreza, çadra, gjethe, oriz, pambuk, makarona, termometër.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:



Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Bëhet ndarja në grupe dhe përpara çdo grupi vendosen shporta me materiale të përgatitura lidhur me njësinë mësimore. Para se të fillojë zbulimi i materialeve, u bëhet e ditur nxënësve se shporta ka të bëjë me njësinë mësimore, p.sh: syze, doreza, gjethe, çadra etj. Pastaj kërkohet që nga shporta ta nxjerrin materialin dhe të tregojnë se për çfarë shërben. Duke u bazuar në motin jashtë, nxënësit fillojnë të tregojnë se çfarë kohe është sot:

- Çfarë na tregon moti?
- Si mund të jetë ai?
- A mund të ndryshojë ai brenda ditës?



Sistemet fizike

4.2 MOTI


Moti na tregon se si duket qielli çdo ditë.
Moti mund të ndryshojë nga dita në ditë.
Ai mund të jetë i thatë (me diell), ditëve të tjera me shi, me borë, me erë etj.

Moti me diell Moti me shi Moti me borë Stuhi

39

Ju mund ta matni motin

- Duke përdorur mjete të ndryshme, ju mund të dini më shumë për motin.
- Termometri është mjet që përdoret për matjen e temperaturës.
- Temperatura na tregon sa i nxehtë ose i ftohtë është një trup.
- Mjetet e tjera ju mundësojnë të matni erën, por edhe shiun.



Ju mund ta dini se çka të vishni, duke parë temperaturën në termometër.
Kur është ngrohtë, ju vishni rroba të holla, ndërsa kur është ftohtë, të trasha.

Veshjet në:



pranverë



verë




vjeshtë



dimër

Cilat nga burimet e dhëna lart për parashikimin e motit i përdor ti?

Hapi 2: Nga materiali i shpërndarë u kërkohet nxënësve që secili grup në mënyrë individuale të japë ide se çfarë simboli të motit mund të bëjnë, duke u bazuar në materialin që është ofruar në shportë. U shpërndahen fletët e bardha, orizi, pambuku, makaronat (p.sh. nëse në shportë ka syze dielli, nxënësit modelojnë simbolin e diellit; nëse në shportë ka çadrën, atëherë marrin pambukun dhe e vendosin në formë të reve, kurse orizin e vënë poshtë tij për të treguar shiun, por nëse ka doreza, ato kanë të bëjnë me simbolin e borës etj.).



Hapi 3: Bazuar në veprimtarinë e zhvilluar vërehet që koha ishte e nxehtë dhe e ftohtë. Nxënësit pyeten:

- Kur ju jeni të sëmurë, me çfarë jua masin temperaturën?
- Ç'mendoni, me çfarë mjeti mund ta matim motin?

Kërkohet nga secili grup (p.sh. nxehtë, ftohtë, freskët etj.) që përmes lojës ekipore të nxiten të gjejnë simbolet e motit.

Në fund, krijohet një kënd arti duke përdorur një spango, ku vendosen punimet radhazi: moti me shi, me diell, me borë dhe stuhi.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen në mënyrë individuale dhe grupore; për shkathtësitë praktike në veprimtari dhe për saktësinë në identifikimin e llojeve të motit dhe përshkrimin e mjeteve për matjen e tij.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Sistemet fizike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon karakteristikat e motit (me shi, me diell, stuhi, borë); përshtatjes me motin në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: III.4,V.1

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.5,2.7

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Moti (përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan veçoritë e motit;
- Përcakton motin nga pamjet e videos.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Nxënësve u parashtrohen disa pyetje, të tilla si:

- Çfarë moti ishte dje?
- Po sot, çfarë moti kemi?
- A ka ndryshuar ai nga mëngjesi deri tani?


Pas përgjigjeve të dhëna, përmes një videoje të përgatitur, nxitet vëmendja e tyre për mësimin në vazhdim.

Hapi 2: Më pas pyeten nxënësit: *Si quhet personi që e prezanton motin?* Shikohet videoja me vëmendje. Gjendet emërtimi dhe u shpjegohet atyre roli i meteorologut.



Si mund të mësoni për kohën?

Që të mësoni për kohën, mund të përdorni mjete për matjen e saj. Ju mund të mësoni për kohën edhe nga parashikimi i motit. Për parashikimin e motit mund të informoheni përmes kompjuterit, radios ose televizorit.



Shenjat që tregojnë për motin:



me diell i vrenjtur me shi stuhi borë mjegull

41

Më pas, përmes pamjeve në projektor imitojnë meteorologun duke treguar motin sipas ditëve në vijim, që gjendet te vegëza: <https://www.youtube.com/watch?v=l7ERkYZRfVs&t=23s>. Veprimtaria vazhdon derisa të kuptohet roli i meteorologut si dhe rëndësia e termometrit, sepse ai dallon nga termometri mjekësor.



Hapi 3: Në mënyrë ekipore gjenden përgjigjet e kuizit të përgatitur më herët, ku nxënësit bëjnë lidhjen e veshjeve me motin.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e veçorive të motit dhe përcaktimin e tij.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Sistemet fizike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan mjedisin përreth, duke përdorur termat *fushë, kodër, mal, përrua, liqen* etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7, II.1, IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mjedi rrethues

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton pjesë të relievit dhe të mjedisit ku jeton;
- Dallon format e tokës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, enë, qese plastike, pjatë e plastikës, shishe, uthull, sodë buke.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematikë, Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Fillon diskutimi me pyetjen:

- Si mendoni ju, çfarë formash mund të ketë toka?

Nxënësve u jepet hapësirë të mendojnë derisa t'i vendosë mësuesja fotot e përgatitura në tabelë.

Pas përgjigjeve, shtrohet pyetja tjetër: Ku jeton kjo kafshë? (P.sh.: deveja jeton në shkretëtirë, ariu i bardhë ose pinguini në akullnaja, dhelpra në bjeshkë, peshku në lumë, liqen, peshkaqeni në oqean e kështu me radhë).



4.3 MJEDISI RRETHUES

Sipërfaqja e tokës nuk është e rrafshët. Ajo ka forma të ndryshme. Nëse ngjiteni në majë të malit, do të vëreni kodra, lugina, lumenj, liqene, ishuj etj.

<p>Ishulli - tokë e rrethuar nga të gjitha anët me ujë</p>	<p>Kodra - pjesë e ngritur e tokës, më e vogël se mali (bjeshka)</p>	<p>Mali (bjeshka) - pjesë e ngritur e tokës më e lartë se të tjerat</p>
<p>Përrua - uji sipërfaqësor që rrjedh përgjatë një shtrati.</p>	<p>Fusha - sipërfaqe toke më e rrafshët.</p>	<p>Lumi - rrjedhë e ujit që derdhet në det</p>
<p>Liqeni - sipërfaqe e madhe e mbushur me ujë dhe e rrethuar nga të gjitha anët me tokë</p>	<p>Deti - sipërfaqe shumë e madhe e mbushur me ujë të kripur dhe e rrethuar me tokë</p>	<p>Ujëvara - vend nga ku uji i lumit ose i përroit bie prej një lartësie të caktuar</p>

Cila nga format e tokës gjendet afër vendbanimit tënd? Diskuto në klasë.

4.3 MJEDISI RRETHUES

Sipërfaqja e tokës nuk është e rrafshët.

Ajo ka forma të ndryshme.

Nëse ngjiteni në majë të malit, do të vëreni kodra, lugina, lumenj, liqene, ishuj etj.

Ishulli - tokë e rrethuar nga të gjitha anët me ujë



Kodra - pjesë e ngritur e tokës, më e vogël se mali (bjeshta)



Mali (bjeshta) - pjesë e ngritur e tokës më e lartë se të tjerat



Përrua - uji sipërfaqësor që rrjedh përgjatë një shtrati.



Fusha - sipërfaqe toke më e rrafshët.



Lumi - rrjedhë e ujit që derdhet në det.



Liqeni - sipërfaqe e madhe e mbushur me ujë dhe e rrethuar nga të gjitha anët me tokë



Deti - sipërfaqe shumë e madhe e mbushur me ujë të kripur dhe e rrethuar me tokë



Ujëvara - vend nga ku uji i lumit ose i përroit bie prej një lartësie të caktuar

Cila nga format e tokës gjendet afër vendbanimit tënd? Diskuto në klasë.

42



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për emërtimin e pjesëve të relievit dhe të mjedisit ku jetojnë, si dhe për dallimin e saktë të formave të tokës.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Hapi 2: U kërkohet nxënësve t'i hapin librat dhe t'i shikojnë figurat, më pas bashkërisht bëhet dallimi në mes të kodrës dhe bjeshtës; lumit, liqenit dhe ujëvarës.

Eksperimenti i vullkanit.

Njoftohen nxënësit se do të kryejnë një eksperiment dhe se çfarë do të bëjnë me materialet që kanë përpara. Kërkohet ndihmë nga ata. Së pari marrim pjatën e letres dhe e vendosim shishen e plastikës mbi të. Më pas marrim qesen e plastikës dhe e mbështjellim shishen me anë të ndihmës se tyre, ku e mbështjellim me letër alumini. E vendosim në një enë më të madhe, e mbushim shishen me ujë të vaktë, i hedhim 7 pika ngjyrë të kuqe, pak detergjent (shampo për larjen e duarve) dhe në fund e hedhim uthullën. E shohim se si do të shpërthejë vullkani pas hedhim së uthullës. (<https://www.youtube.com/watch?v=-ZQESjOqdQk>).



Hapi 3: Pas lëvizjes së akrepave të orës (me figura dhe jo numra) nga secili nxënës, dhe varësisht se cila pamje do t'u qëllojë, do ta vizatojnë dhe ngjyrosin atë në fletët e bardha.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Sistemet fizike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan mjedisin përreth, duke përdorur termat *fushë, kodër, mal, përrua, liqen* etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7,II.7,II.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.3,2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Format e tokës (përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan mjedisin përreth;
- Tregon format e tokës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Pjata plastike, dhe, shishe uji, plastelinë, ngjyra pastel, letra, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Ulen nxënësit në rreth, fillojnë të tregojnë secili për përvojën e tyre gjatë pushimeve me prindër dhe vizitave të ndryshme. (P.sh. te familjarët në fshat, në lumin a liqenin më të afërt.)

Fillon diskutimi dhe herë pas here pyeten se si i kanë vërejtur apo dalluar format në natyrë ku kanë qenë. Ja një përgjigje e mundshme: “Gjatë fundjavës, kur isha për vizitë te gjyshërit, vizitova liqenin, por, më larg, vërejta malet”.

Hapi 2: Hapen librat dhe nxënësve u kërkohet të vizatojnë për përvojën e tyre gjatë vizitës që kanë bërë. Tregojnë se çfarë kanë vërejtur dhe çfarë mbresash u ka lënë.



4.3 MJEDISI RRETHUES

Sipërfaqja e tokës nuk është e rrafshët. Ajo ka forma të ndryshme. Nëse ngjiteni në majë të malit, do të vëreni kodra, lugina, lumenj, liqene, ishuj etj.

Ishulli - tokë e rrethuar nga të gjitha anët me ujë

Kodra - pjesë e ngritur e tokës, më e vogël se mali (bleshka)

Mali (bleshka) - pjesë e ngritur e tokës më e lartë se të tjerat

Përrua - uji sipërfaqësor që rrjedh përgjatë një shtrati.

Fusha - sipërfaqe tokë më e rrafshët.

Lumi - rrjedhë e ujit që derdhet në det.

Liqeni - sipërfaqe e madhe e mbushur me ujë dhe e rrethuar nga të gjitha anët me tokë

Deti - sipërfaqe shumë e madhe e mbushur me ujë të kripur dhe e rrethuar me tokë

Ujëvara - vend nga ku uji i lumit ose i përroit bie prej një lartësie të caktuar

Cila nga format e tokës gjendet afër vendbanimit tënd? Diskuto në klasë.

4.3 MJEDISI RRETHUES

Sipërfaqja e tokës nuk është e rrafshët.

Ajo ka forma të ndryshme.

Nëse ngjiteni në majë të malit, do të vëreni kodra, lugina, lumenj, liqene, ishuj etj.

Ishulli - tokë e rrethuar nga të gjitha anët me ujë




Kodra - pjesë e ngritur e tokës, më e vogël se mali (bjeshka)



Mali (bjeshka) - pjesë e ngritur e tokës më e lartë se të tjerat



Përrua - uji sipërfaqësor që rrjedh përgjatë një shtrati.



Fusha - sipërfaqe toke më e rrafshët.



Lumi - rrjedhë e ujit që derdhet në det



Liqeni - sipërfaqe e madhe e mbushur me ujë dhe e rrethuar nga të gjitha anët me tokë



Deti - sipërfaqe shumë e madhe e mbushur me ujë të kripur dhe e rrethuar me tokë




Ujëvara - vend nga ku uji i lumit ose i përroit bie prej një lartësie të caktuar

Cila nga format e tokës gjendet afër vendbanimit tënd? Diskuto në klasë.

42

Hapi 3: Të ndarë në dyshe, u shpërndahet materiali nxënësve, si dhe udhëzohen se si do të punojnë veprimtarinë gjatë orës mësimore. Secili prej tyre ka detyrën e tij. Njëri mbush pjtën me dhe, ku formëson një nga format e dhëna në foto, tjetri hedh ujin e kështu me radhë.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e përshkrimit të formave të tokës në mjedisin rrethues.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Sistemet fizike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon në hartë ose në glob që pjesa më e madhe e tokës është e mbushur me ujë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.7, III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Harta dhe globi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon karakteristikat e hartës dhe të globit.
- Dallon sipërfaqet ujore dhe tokësore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë, glob, plastelinë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë muzikore, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Merren harta dhe globi.

Ora fillon duke bërë shkurtimisht përsëritje të temës së kaluar. Pra, diskutohet rreth pyetjeve:

- Në cilin planet jetojmë?
- Çfarë forme ka Toka?
- A keni qenë ndonjëherë në kopsht zoologjik?
- Nëse po, si jeni drejtuar te kafshët që donit t'i shihnit?



4.4 HARTA DHE GLOBI


Harta është një vizatim në të cilin tregohen vendet se si duken. Ka harta të ndryshme, si: harta e një ndërtese, harta e një kopshti zoologjik, harta e një shteti, harta e botës etj.

Globi është një model i rrumbullakët që tregon formën e Tokës.

Harta e botës dhe globi tregojnë pjesët tokësore dhe ato ujore të planetit Tokë. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së Tokës është e mbuluar me ujë. Në hartë dhe në glob mund ta dallosh përmes ngjyrës së kaltër.



Globi



Drejtimi i veriut

Harta e botës

Merr hartën dhe globin që gjenden në shkollë. Diskutoni më pas me njëri-tjetrin dhe mësuesen/in për sipërfaqen që zënë uji dhe pjesët tokësore në planetin Tokë.

4.4 HARTA DHE GLOBI

Harta është një vizatim në të cilin tregohen vendet se si duken.
Ka harta të ndryshme, si: harta e një ndërtese, harta e një kopshti zoologjik, harta e një shteti, harta e botës etj.
Globi është një model i rumbullakët që tregon formën e Tokës.

Harta e botës dhe globi tregojnë pjesët tokësore dhe ato ujore të planetit Tokë. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së Tokës është e mbuluar me ujë. Në hartë dhe në glob mund ta dallosh përmes ngjyrës së kaltër.



Globi



Drejtimi i veriut

Harta e botës

Merr hartën dhe globin që gjenden në shkollë. Diskutoni më pas me njëri-tjetrin dhe mësuesin/in për sipërfaqen që zënë uji dhe pjesët tokësore në planetin Tokë.

43

Hapi 2: U tregohet nxënësve se harta dhe globi janë vizatime që tregojnë pjesët tokësore dhe ato ujore të planetit Tokë në të cilat ndodhen kontinentet. Pra, lëvizja nga një kontinent në tjetrin bëhet përmes mjeteve të udhëtimit.

Të ulur të gjithë së bashku, fillojnë të dëgjojnë këngën për kontinentet të cilat gjenden në hartë. Shpjegohet se jemi në Evropë dhe mund të shkojmë në Amerikë.

Nga kënga kuptohet që planeti Tokë është i ndarë në shtatë kontinente.

Numërohen ato me radhë:

Azia, Afrika, Evropa, Amerika Veriore, Amerika Jugore, Australia, Antarktiku.

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet t'i vendosin plastelinat përpara vetes dhe të fillojnë që ta modelojnë globin.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në identifikimin e karakteristikave të hartës e globit dhe dallimin e sipërfaqes ujore e tokësore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Vlerëson ajrin si burim natyror dhe element të domosdoshëm për jetën.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; I.7; II.2; II.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Burimet natyrore: Ajri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon burimet natyrore të nevojshme për jetë;
- Rendit shkronjat duke krijuar fjalën “ajër”;
- Shpjegon rëndësinë dhe rolin e ajrit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Katër balona, etiketa me shkronja, fotografi, fletë punë, kapëse magnetike për kapjen e fletëve në tabelë.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Nxënësvë u paraqitet në fletë A3 një bimë. Shtrohet pyetja: *Çfarë i duhet një bimë për të jetuar?* Duke e parë fotografinë, nxënësit përgjigjen: - *Ajër, diell dhe ujë.* Plotësohen hapësirat në fletë. Merren përgjigjet dhe fillon diskutimi në klasë me pyetje të ndryshme, si:

- Pse i duhet dheu bimës?
- Çfarë i ndodh bimës nëse ajo nuk ujitet?
- Pse gjatë dimrit lulet nuk lulëzojnë?



Pastaj diskutimi orientohet drejt jetës së njerëzve, se a mund të jetohej pa ujë, ajër, ushqim, diell e tokë? Arrihet në përfundimin që sendet që gjenden në tokë dhe janë të nevojshme për të jetuar quhen burime



Ndotja e ajrit

- Kur ka përbërës të dëmshëm në ajër, themi se ai është i ndotur.
- Pluhuri i banesave, i rrugëve, i fabrikave është ndotës. Tymrat e fabrikave, të makinave dhe të zjarrit, po ashtu, janë ndotës.
- Pirja e duhanit brenda shtëpisë shkaktonte ndotje të ajrit.
- Ajri i papastër shkaktonte sëmundje.



Diskutoni me njëri-tjetrin dhe me mësuesen/in për ndotësit kryesorë të ajrit në vendin tonë.

45

natyrore. U shpjegohet fjala *burim* më detajisht, duke u treguar që është prejardhje e diçkaje dhe natyrore, që është nga vetë *natyra*, jo e krijuar nga dora e njeriut.

Hapi 2: Mësimi i sotëm orientohet për të kuptuar vetëm rolin e njërit burim natyror që është *ajri*. Paraprakisht fryhen katër balona. Secila balonë mban një letër me një nga 4 shkronjat e fjalës: AJRI.

Katër nxënës shpërthejnë nga 1 balonë dhe shkronjat që dalin i vendosin në tabelë. Renditen shkronjat, krijohet fjala *Ajri*. Në rast të ndonjë vështirësie, ftohen nxënës të tjerë për të ndihmuar.

Bëhet pyetja:

- Pse pikërisht është zgjedhur balona që të fshihen brenda tyre këto shkronja?

Përgjigje e mundshme duhet të jetë që balona është e mbushur me ajër.

Shoqërohen pyetje të tjera, si:

- Çfarë thithim ne kudo që jemi për të jetuar?
- Çfarë roli tjetër ka ajri në jetën tonë?

Si përgjigje e mundshme mund të jetë që të realizohet fluturimi i shpendëve; loja me fluturake.

Hapi 3: Hapet libri në faqen 45, nxënësit e lexojnë mësimin, për të përforcuar njohuritë e marra dhe detaje të tjera për njësinë.

Hapi 4: Në fletën e punës, të përgatitur, rrethohen gjallesa dhe sende të cilave u duhet ajri për të lëvizur dhe ngjyrosen ato që kanë nevojë për ajër që të lëvizin. Shënohen me ✓ ose me X disa karakteristika të ajrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, për saktësinë e identifikimit të burimeve natyrore dhe shpjegimin e rëndësisë së rolit të ajrit.

Detyrë:

Vizaton tri gjëra që u duhet ajri për të jetuar dhe tri që përdorin ajrin për të lëvizur.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon ndotësit kryesorë të ajrit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I.3; II.6; III.2; IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 1.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e ajrit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon ndotësit e ajrit dhe mënyrat parandaluese;
- Tregon karakteristikat e jetës në ajrin e fshatit a qytetit;
- Heton erën e tymit të letrës së djegur si ndotës i ajrit;
- Harton një listë me veprime parandaluese për ndotjen e ajrit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kovë, ujë, letër, shkrepës, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Në Youtube (<https://www.youtube.com/watch?v=sAKyhfxr7s>) shikohet një video për ndotjen e ajrit. Nga videoja do të kuptohen ndotësit e ajrit, mënyrat e ndotjes dhe veprimet parandaluese. Përfundimi i videos shoqërohet me pyetje diskutimi, si:

- Çfarë shikua?
- Kush po ndotej në video?
- Cilat ishin mënyrat e ndotjes?
- Cilin veprim ke bërë ndonjëherë që nuk do ta bëje më?
- Çfarë mund ta bësh që ta parandalosh ndotjen?

Arrihet në përfundim se si ndotet ajri dhe cilat veprime duhen bërë për ta parandaluar ndotjen e tij.

Hapi 2: Vendoset një fotografi e qytetit dhe një e fshatit dhe bëhet pyetja se ku është më e shëndetshme të jetohet dhe pse. Fotografitë shoqërohen me organizues grafikë si në vijim.

Në bazë të gjetjeve kuptohet që jeta më e shëndetshme është në fshat.




Ndotja e ajrit

Kur ka përbërës të dëmshëm në ajër, themi se ai është i ndotur. Pluhuri i banesave, i rrugëve, i fabrikave është ndotës. Tymrat e fabrikave, të makinave dhe të zjarrit, po ashtu, janë ndotës. Pirja e duhanit brenda shtëpisë shkakton ndotje të ajrit. Ajri i papastër shkakton sëmundje.



Diskutoni me njëri-tjetrin dhe me mësuesen/in për ndotësit kryesorë të ajrit në vendin tonë.

45



Hapi 3: Hapen librat, lexohet mësimi dhe diskutohet. Vrojtohen fotografitë dhe diskutohen veprimet që tregohen në foto.

- Çfarë ajri po thithin fëmijët pranë makinave në rrugë?
- Si ndikon djegia e drunjve në ajër dhe çfarë lirohet nga ky veprim?
- Pse fabrikat duhet të ndërtohen larg vendbanimeve?

Pyetjet për diskutim bëhen varësisht edhe nga përgjigjet e marra.

Hapi 4: Merret një kovë dhe mbushet me ujë (uji shërben për fikjen e letres së djegur). Mbi kovë do të digjet një letër. Fëmijët do të kenë mundësi të ndiejnë tymin që çlirohet dhe të vërejnë ajrin e ndotur të shkaktuar nga djegia e

letres, duke e kuptuar kështu më specifikisht mënyrën e ndotjes së ajrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, saktësinë në identifikimin e ndotësve të ajrit, shpjegimin e karakteristikave dhe hartimin e veprimeve parandaluese të ndotjes së tij.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan tokën dhe ujin si burime shumë të rëndësishme natyrore për jetën në mjedis.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2; IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.3; 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Uji

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon pjesët e tokës të mbuluara me ujë;
- Shpjegon domosdoshmërinë e ujit për jetën;
- Përshkruan procesin e filtrimit të ujit nëpërmjet eksperimentit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Glob ose hartë botërore, një enë e madhe e pastër me ujë të pijshëm, gota plastike për secilin, një enë e madhe e pastër me ujë të ndotur (ujë nga lumi).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Globalizimi dhe ndërvarësia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Kërkoheq që nxënësit në rreth të mblidhen afër tryezës ku janë vendosur dy enë me ujë dhe gota. Nxiten të parashikojnë se çfarë do të mësojnë. Kërkoheq të përmendin disa burime uji, si: çezma, burimet, lumenjtë etj. U shpjegohet nxënësve se uji është kudo rreth nesh, madje edhe trupi i tyre është i ndërtuar nga uji.

Hapi 2: Hapen librat dhe shikojnë hartën e botës ku uji përbën pjesën më të madhe të globit. Diskutohet me nxënësit nevoja e përdorimit të ujit. Renditin disa mënyra të përdorimit të tij. Krahasohet uji i detit me ujin e lumit për nga shija. Nxënësve u parashtrohen pyetje, si:

Uji është burim natyror, i domosdoshëm për jetën e organizmave të gjallë.
Ai mbulon pjesën më të madhe të tokës.
Shumica e ujit ndodhet në dete dhe në oqeanë.
Detet dhe oqeanet kanë ujë të kripur.
Lumenjtë dhe liqenet kanë ujë të ëmbël.



Uji i lumit



Uji i detit

Ne e përdorim ujin në mënyra të ndryshme.
Për pirje e përdorim ujin e ëmbël. Ujin e përdorim edhe për pastrim dhe për të përgatitur ushqime.



4.6 UJI

Uji është burim natyror, i domosdoshëm për jetën e organizmave të gjallë.
Ai mbulon pjesën më të madhe të tokës.
Shumica e ujit ndodhet në dete dhe në oqeanë.
Detet dhe oqeanet kanë ujë të kripur.
Lumenjtë dhe liqenet kanë ujë të ëmbël.



Uji i lumit



Uji i detit

Ne e përdorim ujin në mënyra të ndryshme.
Për pije e përdorim ujin e ëmbël. Ujin e përdorim edhe për pastrim dhe për të përgatitur ushqime.



46

- A keni provuar të pini ujë nga deti?
- A e dini pse uji i detit nuk është i pijshëm?

Arrihet në përfundim se uji nga deti nuk mund të pihet se është i kripur. Më pas shpjegohet se as uji i lumenjve ashtu siç është nuk mund të pihet. Ai duhet të kalojë nëpër disa filtra. Duhet pirë vetëm ujë të pastër. U ofrohet nga një gotë ujë nga ena me ujë të pastër secilit dhe vazhdohet me eksperimentin.

Hapi 3: Eksperiment - Krijimi i filtrit të ujit


Materiali i nevojshëm:

- Shishe plastike e ndarë në gjysmë;
- Rërë, guraleca, zhavorr, copa pambuku;
- Ujë të ndotur me rërë ose ujë nga lumi më i afërt.

Veprimet:

1. Vendoset gjysma e sipërme si një hinkë brenda gjysmës së poshtme;
2. Shtrohet gjysma e sipërme me zhavorr, lesh, pambuk, rërë (në fund pambuk, pastaj rërë, guraleca dhe sipër zhavorr).
3. Hidhet uji i ndotur sipër dhe nxiten fëmijët të shohin ujin e pastër që vjen përmes filtrit.

Diskutohet me nxënësit mënyra e filtrimit të ujit në klasë dhe rezultatet e fituara. Arrihet në përfundim se uji për t'u përdorur për pije kalon nëpër disa filtra dhe kur të jetë i sigurt për pije kalon përmes çezmës në shtëpitë tona. Uji i papastër përmban mikroba të cilat mund të na sëmurin.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shpjegimin e rëndësisë së ujit për jetën, mënyrën e përdorimit të tij dhe procesin e filtrimit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan tokën dhe ujin si burime shumë të rëndësishme natyrore për jetën në mjedis.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: III.3; III.6; IV.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.3; 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Uji (përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Diskuton për përdorime të ndryshme të ujit;
- Shpjegon jetesën e njerëzve pranë burimeve të ujit;
- Rendit disa mënyra të përdorimit dhe të kursimit të ujit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, fotografi nga vendi i ngjarjes, fletë punese, mjete shkrimi, ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Matematikë, Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Globalizimi dhe ndërvarësia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit të ulen në gjysmërreth. Shpjegohet se uji është pjesë thelbësore e jetës, dhe pa të nuk ka jetë. Diskutohet për të gjitha mënyrat se si përdoret uji në jetën e përditshme.

Bëhen pyetje:

- Si e përdorni ujin?
- Nga vjen uji?
- Si duhet ta kursejmë?
- Sa gota ujë duhet të pimë në ditë?


Përgjigjet e tyre shkruhen në tabelë në “Hartën e të menduarit”. Shoqërohen përgjigjet e tyre me vizatime dhe fotografi për mënyrat e përdorimit të ujit në jetën e përditshme.

Hapi 2: Kërkohet nga nxënësit në grupe të masin sasinë e ujit që përdorin në ditë. Mbushin 5 gota ujë, të cilat i derdhin në një enë dhe më pas në enën matëse. Ata duhet të parashikojnë sa janë 5 gota



4.6 UJI

Në rrahët e mëposhtëm, shkruani se si e përdorni dhe si e kurseni ujin!




37

ujë, pas matjes vërtetojnë parashikimet e tyre. Kjo veprimtari u jep nxënësve besim për të bërë parashikime dhe për t'i vërtetuar ato. Shpjegohen përgjigjet e tyre nga fillimi. Arrihet në përfundim se:

1. Uji përdoret për pije, për gatim, për pas-trim, për ujitjen e kopshtit etj.
2. Uji kursehet kur ndalet çezma apo kur përdoret ujë jo i pijshëm për ujitjen e kopshtit etj.

Hapi 3: Nxënësit i hapin fletoret e punës.

U shpjegohet atyre se çfarë të plotësojnë për mënyrën si e përdorin ujin dhe si duhet ta kursen atë. Plotësohen vendet e zbrazëta me vizatime, duke u ndihmuar nga përgjigjet e tyre të paraqitura në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrje aktive, për mënyrat e përdorimit të ujit dhe shpjegimin e jetesës së njerëzve pranë burimeve.

Detyrë:

Krijon një poster për kursimin e ujit sipas shembullit të dhënë në fletën punuese.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan një mjedis të ndotur dhe të pastër jetësor përmes përdorimit të vizatimeve, fotografive etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7; III.3; IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.2; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e ujit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Regjistron në mjedisin më të afërt gjendjen e ujit;
- Ndërmerr veprime për mbrojtjen e ujit nga ndotja;
- Prezanton me anë të fotografive rezultatet e arritura.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotoaparati, fletë të bardha, gërshërë, ngjitës, ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Artet, Gjuhë amtare (shqipe), Globalizimi dhe ndërvarësia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Paraprakisht është realizuar një vizitë me nxënësit në lumin më të afërt të vendit ku banojnë. Ata kanë vëzhguar nga afër mjedisin rreth lumit. Nxënësit kanë fotografuar gjendjen reale dhe, të pajisur me mjete mbrojtëse, kanë filluar ta pastrojnë mjedisin rreth lumit. Nëpërmjet kësaj vizite ata do ta kuptojnë se si njerëzit ndikojnë në ndotjen e ujit. Nxënësit do të mbledhin fotografi, do t'i regjistrojnë ato dhe do të bëjnë pyetje të ndryshme për ndotjen e ujit që ndikon në rrezikimin e jetës së gjallesave.

Hapi 2: Nxënësve u parashtrohen pyetjet:

- Cilat janë mënyrat me të cilat njerëzit e ndotin ujin?
- Si mund të ndalet ndotja e ujit?
- Po ju, çfarë mund të bëni?



Ndotja e ujit

- Uji ndotet kur në të gjenden gjëra që dëmtojnë shëndetin tonë.
- Mbeturinat e ndotin ujin. Hedhja e vajit në ujë e ndot atë.
- Uji i ndotur i dëmton gjallesat.

Ujë i pastër



Ujë i ndotur

Si ta mbrojmë ujin nga ndotja?

47

Përkrahja e fotografitë e bëra gjatë vizitës në lumë dhe tregojnë se si ata i kanë pastruar mbeturinat rreth tij. Fotot e printuara ose vizatimet e tyre i vendosin në kolonën “Lumi im”, dhe veprimet që i kanë ndërmarrë në kolonën tjetër. Në fund i vendosin fotografitë me gjendjen e lumit pas pastrimit.

Lumi im 	Veprimet tona	Lumi im 
		

Hapi 3: Klasa ndahet në grupe me nga pesë nxënës, të cilët në grup diskutojnë mbi veprimin e njerëzve në shkatërrimin e mjedisit dhe mbytjen e gjallesave që jetojnë në ato mjedise.

Secili grup shkruan nga një kujtesë për mbrojtjen e ujit. Këto kujtesa i vendosin në pemë afër lumit të pastruar.

MOS HIDHNI
MBETURINA
NË UJË.

UJI ËSHTË JETË,
MBROJE!

MOS MË
MBYT!

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për regjistrimin e gjendjes së ujit, veprimet për pastrimin e ujit nga ndotja dhe mënyrën e prezantimit të rezultateve.

Detyrë:

Plotëson fletën punuese të bashkëngjitur më poshtë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan tokën dhe ujin si burime shumë të rëndësishme natyrore për jetën në mjedis.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.7, II.4, III.1, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Toka

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Bashkon saktë pjesët e dhëna për të formuar figurën e duhur;
- Përshkruan rolin e pemëve, të perimeve, të kafshëve në tokë;
- Shpjegon lidhshmërinë që ka toka me njeriun, bimët dhe kafshët.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi nga interneti, plastelinë.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare (shqipë), Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Nxënësit punojnë në grupe, ku bashkojnë copëzat e dhëna (foto të printuara me ngjyra dhe të ndara në copëza). Pas bashkimit të pjesëve, përftojnë figurën e Tokës, të perimeve, të pemëve dhe të kafshëve.



4.7 TOKA

Dheu është shtresa e sipërme e Tokës.
Toka është burim natyror; shumica e bimëve rriten në të dhe shumë kafshë jetojnë aty. Nga toka marrim shumicën e gjërave të nevojshme për jetë, p.sh.: bimët, të cilat i përdorim për ushqim (drithërat, perimet, frutat etj.), rriten në tokë. Nga bimët që rriten në tokë ushqehen bagëtia (nga bagëtitë marrim mishin, qumështin, leshin etj.), po ashtu, nga toka marrim pasuritë minerale etj.



48

Hapi 2. Kërkohet nga grupet të komentojnë figurën e formuar, duke treguar për rëndësinë e tokës, kafshëve, pemëve dhe perimeve në mjedis.

Hapi 3: Nxiten nxënësit t' u përgjigjen pyetjeve të shtruara.

- Çfarë të mirash kemi nga toka?
- Si mund ta mbajmë tokën të pastër?
- Për çfarë e përdorim tokën?
- Çfarë i lidh njerëzit, kafshët, bimët dhe tokën?

Diskutohen mendimet e nxënësve.

Shembull: Toka është planet, ku jetojnë njerëzit, kafshët dhe bimët. Njerëzit duhet të kujdesen për pastërtinë e tokës duke mos hedhur mbeturina në tokë. Toka është burim natyror, ku rriten bimët, nga të cilat ushqehen njerëzit dhe kafshët.

Nga kafshët marrim mishin, qumështin, leshin. Nga toka nxjerrim minerale të ndryshme etj.

Hapi 4: Me plastelinë modelojnë formën e tokës dhe të mirat që marrim nga ajo. Puna bëhet në grupe.

Pas përfundimit, nxënësit paraqesin modelimet para të tjerëve, duke përshkruar me fjalë punën që kanë bërë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, saktësinë në formimin e figurës, përshkrimin e karakteristikave të tokës dhe lidhshmërinë që ka toka me botën e gjallë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: I

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan një mjedis të ndotur dhe të pastër jetësor përmes përdorimit të vizatimeve, të fotografive etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e tokës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon faktorët që ndikojnë në ndotjen e mjedisit;
- Përshkruan rëndësinë e mjedisit të pastër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Hapi 1: Në tabelë shënohen tri fjali. Kërkohet nga nxënësit t'i plotësojnë fjalitë, duke rikujtuar njësinë e mësuar më parë.

Toka është_____ . (planet)

Në tokë jetojnë_____, _____ dhe _____. (njerëzit, kafshë dhe bimët)

Nga toka marrim_____. (ushqime, si pemë, perime, drithëra, minerale).

Më pas shtrohet pyetja: *Çfarë mendoni ju, cilët faktorë ndikojnë në ndotjen e mjedisit (tokës)?*



Ndotja e tokës

Mbeturinat që hidhen në tokë e ndotin atë. Mbeturinat dëmtojnë bimët dhe kafshët që jetojnë në tokë, si dhe shëndetin tonë.



Mjedisi i ndotur me mbeturina



Mjedisi i pastër

Diskutoni me njëri-tjetrin dhe me mësuesen/in për mbeturinat që hidhen në mjedisin ku jeton. Çka mund të bësh ti që ta ruash tokën nga ndotja?

49

Hapi 2: Para klasës shfaqet një këngë e shoqëruar me video, “Planeti i fëmijëve”, e cila paraqet planetin Tokë dhe karakteristikat e tij, si dhe mbrojtjen e tokës nga ndotja.

Kjo këngë gjendet në vegëzën:

<https://www.youtube.com/watch?v=5uFX-fMIgPY8>.

Hapi 3. Diskutohet me nxënësit duke shtruar pyetje të ndryshme lidhur me ndotjen e mjedisit dhe ruajtjen e tij.

- Si ndotet mjedisi ku jetojmë?
- Kë e dëmton ndotja e mjedisit?
- Çfarë mund të bëni ju që ta mbani të pastër mjedisin jetësor?

Hapi 4: Udhëzohen nxënësit të plotësojnë në fletore të punës, duke dhënë sqarimet e duhura. Që të ruhet mjedisi, duhet të realizohen veprimet që përshkruhen në fjalitë e mëposhtme. Fjalitë plotësohen me fjalët e dhëna: *presim, ndalim, makinën, biçikletë, riciklushme, shportë, fikim, peshqit, mbeturinat, digjen, ajrin, shportës, mbill, transportin.*

1. Ne nuk duhet t'i _____ drurët. (presim)
2. _____ më shumë bimë. (Mbill)
3. Në shkollë duhet të shkojmë me _____. (biçikletë)
4. Përdor më shumë _____ publik, në vend të _____. (transportin, makinës)
5. Ne duhet ta _____ rubinetin, kur jemi duke fërkuar dhëmbët, dhe pas çdo përdorimi të ujit. (ndalim)
6. Kur dalim nga dhoma, dritat dhe televizorin duhet t'i _____. (fikim)

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, për përshkrimin e mjedisit të ndotur dhe të pastër, faktorët ndikues, si dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit.

Detyrë:

Vizaton mjedisin ku jeton.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: I

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan një mjedis të ndotur dhe të pastër jetësor përmes përdorimit të vizatimeve, të fotografive etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.4, III.1, III.4, IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.3, 2.3, 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Si ta ruajmë mjedisin?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon një mjedis të ndotur nga ai i pastër;
- Identifikon ndotësit e mjedisit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kavanoz qelqi, shishe dhe kapakë plastike, tela lakues, kanaçe, faculeta.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Që në fillim grupeve u shpërndahet nga një zarf me etiketat e formuara të fjalëve: MJEDIS, MBETURINA, PYJE, PARKU, LUMË. Pastaj u kërkohet të formojnë fjalët. Punojnë në grupe për 2-3 minuta, më pas i lexojnë fjalët e formuara.

Fillohet me diskutimin, duke parashtruar pyetje të tilla, si:

- Si duhet ta ruajmë mjedisin?
- Ku duhet t'i hedhim mbeturinat?
- Çfarë na rrezikon djegia e pyjeve?
- Po lumi, sa dëmtohet nga mbeturinat?

Pas përgjigjeve të marra, paraqiten në projektor disa fotografi dhe komentohen së bashku:

- Çfarë shohim dhe ku duhet t'i hedhim mbeturinat?



Mbeturinat duhen hedhur në shportë. Ato duhet t'i ndani dhe t'i vendosni në shportat përkatëse. Pastaj ato dërgohen në deponinë e mbeturinave. Asnjëherë nuk duhet t'i hidhni mbeturinat jashtë shportës!



51

Hapi 2: Nga materiali i përgatitur për secilin grup dhe për secilin lloj të mbeturinave, p.sh: kavanoz qelqi, shishe dhe kapakë plastikë, tela lakues, kanaçe, faculeta, letër. Nga shportat e improvizuara që janë të vendosura etiketat për materialin përkatës. Kërkohej që secili prej tyre të hedhë mbeturinën në shportën përkatëse.



Pyeten:

- Ne i hodhëm mbeturinat në shportë, po ku do t'i dërgojnë ato?

Pas disa përgjigjeve, kërkohej t'i hapin librat dhe të lexojnë për deponimin e mbeturinave, si dhe për klasifikimin e tyre.



Hapi 3: U shpërndahen fletët me numra dhe në mënyrë enigmatike do të ndërtojnë figurën e dhënë.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e mjedisit të ndotur nga ai i pastër, identifikimin e ndotësve dhe pjesëmarrjen aktive në veprimtari.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** I

Tema: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan një mjedis të ndotur dhe të pastër jetësor përmes përdorimit të vizatimeve, të fotografive etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.7, III.2, V.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6, 2.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ta ruajmë mjedisin ku jetojmë (përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon ndotësit e mjedisit ku jeton;
- Tregon veprime që promovojnë mjedisin e pastër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Pako, shishe plastike, kapak kavanozësh, lidhëse flokësh, pipëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen fletët e bardha dhe u kërkohet të vizatojnë përafërsisht mjedisin që i rrethon. Në të njëjtën kohë bëhet përsëritje e njësisë së kaluar, duke i nxitur ata për imagjinatën e tyre rreth mjedisit. Pas përfundimit të vizatimit kërkohet që secili ta prezantojë mjedisin duke iu përgjigjur pyetjeve të bëra nga njëri-tjetri.



This year we had a summer party. We buried my whole class from school. We ate hotdogs and hamburgers and we slept in tents in my back yard. It was really fun!

Ju mund ta ruani mjedisin, duke:

- i ndarë mbeturinat sipas shportave;
- përdorur qese të riciklueshme;
- organizuar aktivitete për mbrojtjen e mjedisit etj.



Përdorni më pak letër.

Përdorni më shumë herë gjërat në vend se t'i hidhni. Nëse i përdorni gjërat disa herë, nuk keni nevojë të blini shpesh të reja. Kështu, mund të kurseni dhe ta ruani mjedisin.

Nuk duhet ta keqpërdorni ujin. Gjithmonë, kur nuk ju duhet uji, duhet ta ndalni rubinetin. Nëse e lini ujin të rrjedhë panevojshëm, atëherë e keni keqpërdorur atë.

Diskutoni me njëri-tjetrin dhe me mësuesen/in se pse duhet t'i hedhim mbeturinat në vendin e duhur.

52

Ju mund ta ruani mjedisin, duke:

- i ndarë mbeturinat sipas shportave;
- përdorur qese të riciklueshme;
- organizuar aktivitete për mbrojtjen e mjedisit etj.



Përdorni më pak letër.

Përdorni më shumë herë gjërat në vend se t'i hidhni. Nëse i përdorni gjërat disa herë, nuk keni nevojë të blini shpesh të reja. Kështu, mund të kurseni dhe ta ruani mjedisin.

Nuk duhet ta keqpërdorni ujin. Gjithmonë, kur nuk ju duhet uji, duhet ta ndalni rubinetin. Nëse e lini ujin të rrjedhë panevojshëm, atëherë e keni keqpërdorur atë.

Diskutoni me njëri-tjetrin dhe me mësuesen/in se pse duhet t'i hedhim mbeturinat në vendin e duhur.

52

Hapi 2: Nxënësve u shpërndahen zarfet me etiketa të përgatitura me fjalët e sakta dhe u kërkohet t'i vendosin në vendet e zbrazëta. Më pas u lexohet teksti në libër duke u kërkuar vëmendje që të mbajnë mend atë që u lexua.

Hapen librat dhe bashkërisht me zarfet e shpërndara i vendosin etiketat në vendet e zbrazëta. Pastaj përsëritet edhe një herë së bashku që të vihet re se sa ishin të vëmendshëm në vendosjen e etiketave, si dhe u shpjegohen shprehjet e reja të cilat nuk i kanë dëgjuar më parë.

MBILL

TË
RICIKLUESHME

PRESIM

Ne nuk duhet t'ipresim.....drurët.

Në vend të qeseve të zakonshme ne duhet të përdorim qese ...të riciklueshme....

Hapi 3: Në libër plotësohet figura e dhënë ku duhet gjetur rruga se në cilën shportë duhet të shkojnë llojet e caktuara të mbeturinave.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e ndotësve në mjedisin jetësor dhe përcaktimin e veprimeve parandaluese për mbrojtjen e tij.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

